



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. 84/5 prot.

Tiranë, më 17.2.2023

- Lënda:** Ankim i Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 607, datë 22.12.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit z. Kledian Llaho
- Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
- Për kompetencë:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese
- Për dijeni:** Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)
- Depozituar pranë:** Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Të nderuar gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese,

Në zbatim të nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, në datën 6.2.2023, është njoftuar vendimi nr. 607, datë 22.12.2022, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin në rivlerësim, z. Kledian Llaho, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Sarandë.

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C, pika 2, nenit F, pika 2, të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 63, pika 1, të ligjit nr. 84/2016, ka të drejtë të ankimojë vendimin brenda afatit 15-ditor, nga njoftimi.

Brenda afatit ligjor, Komisioneri Publik ushtron ankim ndaj vendimit nr. 607, datë 22.12.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

I. Procesi i rivlerësimit dhe përfundimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Subjekti i rivlerësimit, z. Kledian Llaho, është subjekt i rivlerësimit sipas nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016), për shkak të funksionit të tij si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Sarandë.

2. Bazuar në nenin Ç, pika 1 e aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit kalimtar për subjektin z. Llaho ka përfshirë kontrollin dhe rivlerësimin e të tria kriteve, atë të pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale.

3. Për këtë qëllim, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim referuar si Komisioni), ka administruar raportet e vlerësimit për këtë subjekt nga institucionet ndihmëse, si Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim referuar si ILDKPKI), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim referuar si DSIK), dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim referuar si KLP), nga të cilat rezulton se:

3.1 ILDKPKI, bazuar në nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, me anë të “*Aktit të përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë për subjektin Kledian Llaho*”, ka referuar: (i) deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin; (ii) ka mungesë të dokumentacionit ligjor për të justifikuar pasuritë; (iii) nuk ka kryer fshehje të pasurisë; (iv) nuk ka kryer deklarim të rremë; (v) janë përfituar të ardhura në kushtet e konfliktit të interesave.

3.2 DSIK, bazuar në nenin 39, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, ka dërguar në Komision raportin me nr. ***, datë **.10.2017¹, në të cilin ka konstatuar përshtatshmërinë në vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit. Komisioni ka kërkuar përditësimin e të dhënave nga organet ligjzbatuese, nga ku ka rezultuar një informacion konfidencial, për të cilin nuk ka pasur të dhëna/zhvillime të mëtejshme.

3.3 KLP, bazuar në nenin 43, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të rishikimit të dokumenteve ligjore të përpiluara nga subjekti gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, ka përcjellë pranë Komisionit raportin për analizimin e aftësive profesionale të subjektit.

4. Përfundimet e Komisioni, për secilin kriter kontrolli, në mënyrë të përmbledhur, janë si vijon:

4.1 ***Për vlerësimin e pasurisë.*** Në përfundim të procesit të rivlerësimit, referuar nenit D të aneksit të Kushtetutës dhe dispozitave të kreut IV të ligjit nr. 84/2016, Komisioni krijoi bindjen se subjekti i rivlerësimit Kledian Llaho ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të germës “a”, të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, pasi përmbush kriteret e nenit 33 të këtij ligji, për shkak se: (i) ka kryer deklarime të sakta në përputhje me ligjin (germa “a” e pikës 5); (ii) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë dhe shpenzimet gjatë gjithë periudhës së rivlerësimit (germa “b” e pikës 5); (iii) nuk ka kryer fshehje të pasurisë (germa “c” e pikës 5); si dhe (iv) nuk është gjendur në kushtet e konfliktit të interesit në dukje (germa “d” e pikës 5).

4.2 ***Për kontrollin e figurës.*** Në procesin e vlerësimit përfundimtar të kriterit të figurës, Komisioni nuk evidentoi prova, fakte dhe rrethana që cenojnë figurën e subjektit të rivlerësimit për shkak të veprimtarisë korruptive apo kontakteve me persona të përfshirë në krimin e organizuar, të cilat do të ndryshonin konstatimin e Grupit të Punës të DSIK-së, duke çmuar se subjekti i rivlerësimit Kledian Llaho është i përshtatshëm për vijimin e ushtrimit të detyrës, për shkak se ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

4.3 ***Për vlerësimin e aftësive profesionale.*** Në përfundim, për subjektin është vlerësuar se: (i) ka treguar aftësi të mira profesionale sipas nenit 73 të ligjit nr. 96/2016; (ii) ka treguar aftësi të

¹ Deklasifikuar pjesërisht me vendimin nr. ***, datë **.6.2021, të KDZH-së.

mira organizative sipas nenit 74 të ligjit nr. 96/2016; (iii) ka treguar etikë dhe angazhim ndaj vlerave profesionale sipas nenit 75 të ligjit nr. 96/2016; si dhe (iv) ka treguar aftësi personale dhe angazhim profesional sipas nenit 76 të ligjit nr. 96/2016. Për rrjedhojë, sipas germës “a”, të nenit 44, të ligjit nr. 84/2016, me propozim të relatores së çështjes, subjekti i rivlerësimit është vlerësuar “i aftë” profesionalisht, për shkak se ka arritur nivelin kualifikues për vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të germës “c”, të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.

5. Në përfundim të procedurës së rivlerësimit, pas zhvillimit të seancës dëgjimore, Komisioni, në bazë të nenit 58, pika 1, germa “a”, dhe nenit 59, pikat 1 dhe 4, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ndër të tjera, ka vendosur:

- *Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Kledian Llaho, me funksion prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Sarandë.*

II. Shkaqet e ankimit

6. Në kuptim të nenit 179/b të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioneri Publik është një nga tri institucionet e ngarkuara për kryerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar (Vetting).

7. Bazuar në këto parashikime kushtetuese dhe ligjore, Komisionerit Publik, si përfaqësues i interesit publik në kryerjen e këtij procesi, i njihet e drejta e ankimit kundër vendimeve të Komisionit dhe paraqitjen e tyre juridiksionit rivlerësues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit (në vijim referuar si Kolegji).

8. Në krahasim me kompetencat kushtetuese dhe ligjore që u njihen Komisionit dhe Kolegjit nga neni Ç i aneksit të Kushtetutës dhe nenet 48-52, të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit, ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit nga ana e Komisionit.

9. Në të tilla rrethana ligjore, me qëllim garantimin e mbrojtjes së interesit publik gjatë procesit të rivlerësimit, Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, duke vlerësuar nëse vendimmarrja e tij është në përputhje me kërkesat kushtetuese e ligjore, bazohet në një hetim administrativ të gjithanshëm e shterues, vlerësim të drejtë të provave, si dhe në përputhje me jurisprudencën orientuese të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

10. Edhe në rastin konkret, Komisioneri Publik, mbështetur në kompetencën e tij kushtetuese dhe ligjore, konstaton se nga shqyrtimi i vendimit nr. 607/2022, të Komisionit dhe akteve shoqëruese të tij, paraqiten gjetje dhe rrethana të tilla ligjore e fakti, që nuk përmbushin kriteret dhe standardet e etikës dhe rregullat e sjelljes, që garantojnë mbrojtjen dhe forcimin e besimit të publikut, të parashikuara me ligjin nr. 96/2016, i ndryshuar, duke përbërë në këtë mënyrë shkaqet për vlerësimin tërësor të procedurave, sipas përcaktimit të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

11. Për sa më sipër, bazuar në nenin C, pika 2, nenin F, pikat 3 dhe 7, të aneksit të Kushtetutës, si dhe nenin 4 dhe 66, të ligjit nr. 84/2016, ky ankim i Komisionerit Publik ndaj vendimit nr. 607, datë 22.12.2022, të Komisionit, ushtrohet për të tria kriteret, në vlerësimin tërësor të procedurave.

III. Analiza e shkaqeve të ankimit

III.A. Lidhur me kriterin e kontrollit të pasurisë

12. Interesat privatë dhe pasurorë, të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, janë deklaruar fillimisht në “Deklaratën e personit që mbart detyrimin për deklarim pasurie”, për vitin 2003, e më pas në vitin 2004, në cilësinë e oficerit të Policisë Gjyqësore. Subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar deklaratën para fillimit të detyrës në cilësinë e prokurorit, dorëzuar në ILDKPKI më datë **.7.2014 dhe në vijim në deklaratat periodike për vitet 2014 - 2016 (këtu e në vijim referuar si DV-20...), dhe në Deklaratën “Vetting” (këtu e në vijim referuar si D-Vett.), dorëzuar në ILDKPKI në datën **.1.2017.

13. Nga shqyrtimi dhe krahasimi i deklaratave si më sipër, referuar nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, në funksion të nenit D, të aneksit të Kushtetutës, konstatohet sa në vijim:

14. Depozitë bankare në *** Bank, vlera 5.000.000 lekë, çelur në datën **.7.2015

14.1 Në D-Vett., subjekti deklaron: *Depozitë bankare në *** Bank, çelur në datën **.7.2015, me afat dyvjeçar dhe interes 3.5 %, si rezultat i shitjes së apartamentit me sip. 105 m², kontratë shitje nr. *** rep. dhe nr. *** kol., para noterit ***.***, datë **.4.2015. Apartament i ndodhur në lagjen nr. **, Durrës, blerë në muajin mars 2014, me të ardhurat: (i) pjesërisht nga kursimet familjare; (ii) nga kredia në *** Bank; (iii) ndihmesë nga vëllai i punësuar në Itali; dhe (iv) pjesërisht ndihmesë nga prindërit e bashkëshortes. Vlera: 5.000.000 lekë. Pjesa takuese: 100 %.* Subjekti nuk deklaron vlerat përkatëse të ndihmesës nga vëllai apo nga prindërit e bashkëshortes.

14.2 Në deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës, dorëzuar në ILDKPKI, në datën **.7.2014, subjekti deklaron: *(i) Apartament me sipërfaqe 105 m² i ndodhur në lagjen nr. ***, rruga “***”, Durrës. Blerë në muajin mars 2014. Burimi i krijimit: (i) pjesërisht nga kursimet familjare, (ii) nga kredia në *** Bank; dhe (iii) pjesërisht ndihmesë nga prindërit e bashkëshortes. Vlera 50.000 euro dhe pjesa takuese 50%. Subjekti nuk deklaron vlerën e ndihmesës nga prindërit e bashkëshortes.*

14.3 Në DV-2015, në rubrikën “Ndryshimet e pasurive”, subjekti deklaron: Në datën **.4.2015 është shitur apartamenti me sip. 105,26 m², në lagjen nr. *** Durrës, në bashkëpronësi me bashkëshorten, kontratë shitje nr. *** rep. dhe nr. *** kol., para noter ***.***, datë **.4.2015.

14.4 Në të njëjtën deklaratë, në rubrikën “Detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”, subjekti deklaron se më të ardhurat nga shitja e apartamentit është mbyllur kredia në *** Bank në datën **.4.2015, dhe është çelur kontratë depozite me afat, në vlerën 5 milionë lekë në *** Bank.

15. Lidhur me pasurinë “apartament me sip. 105 m²”, ndodhur në lagjen nr. ***, Durrës, nga shitja e të cilit është krijuar depozita në vlerën 5.000.000 lekë në *** Bank, nga aktet në dosje rezultojnë sa vijon:

15.1 ASHK Durrës, me shkresën nr. *** prot. (nr. *** prot.), datë **.8.2021, konfirmon se në emër të Kledian dhe bashkëshortes, znj. ***.***, ka qenë e regjistruar pasuria e llojit “apartament” me nr. ***, z. k. ***.

15.2 Me kontratën e sipërmarrjes datë **.7.2010, Kledian Llaho ka porositur pranë shoqërisë “***” sh.p.k., me administrator ***.***, një apartament me sipërfaqe totale 113 m², në Durrës, L.***, rruga “***”, në shumën 54.000 euro;

15.3 Me kontratë shitblerje nr. *** rep., nr. *** kol., datë **.3.2014, Kledian Llaho ka blerë nga shoqëria “***” sh.p.k., me administrator ***.***, pasurinë “apartament me sipërfaqe 105,26 m²”, me nr. ***, në shumën 50.000 euro²;

15.4 Subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të, me kontratën e shitjes me rezervë nr. *** rep., nr. *** kol., datë **.4.2015, i kanë shitur shtetasit ***.***, pasurinë apartament me sipërfaqe 105 m², me nr. pasurie ***, zk. ***, në Durrës, në shumën 7.000.000 lekë.

16. *Lidhur me burimin e krijimit të pasurisë apartament me sip. 105 m²*

16.1 Komisioni gjatë hetimit administrativ ka konstatuar se: Në D-Vett., subjekti ka deklaruar si burim: (i) pjesërisht nga kursimet familjare; (ii) nga kredia në *** bank; (iii) ndihmesë nga vëllai i punësuar në Itali; dhe (iv) pjesërisht ndihmesë nga prindërit e bashkëshortes.

16.2 Në deklaratën para fillimit të detyrës, si burim krijimi për apartamentin është deklaruar: (i) kursime familjare; (ii) kredi në *** Bank; dhe (iii) pjesërisht ndihmesë nga prindërit e bashkëshortes.

16.3 Ndërsa, në deklaratimet pranë ILDKPKI-së,³ në datën **.2.2016, subjekti ka deklaruar si burime: (i) Kredi në vlerën 2.500.000 lekë; (ii) Ndihmë nga prindërit e bashkëshortes në shumën 1.500.000 lekë, ku një pjesë prej 7.000 euro është kaluar në llogari bankare të djalit; (iii) Ndihmesë nga vëllai ***.***, në shumën prej 7.000 euro; (iv) Një shumë prej 600.000 lekë dhënë nga nëna; (v) Pjesa tjetër, prej rreth 1.400.000 lekë, janë kursime nga paga e tij dhe e bashkëshortes.

16.4 Komisioni i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të sqarojë arsyet e mosdeklarimit në deklaratën periodike para fillimit të detyrës të vitit 2014, *ndihmën nga vëllai i punësuar në Itali dhe shumën e dhënë nga nëna e tij*, dhe në Deklaratën “Vetting”, *ndihmën nga nëna*. Gjithashtu i ka kërkuar të saktësojë periudhën e marrjes së diferencës së mbetur të shumës 1.500.000 lekë, nga 7.000 euro të kaluara në llogari, nga vjehri, si dhe kohën e marrjes së shumës 600.000 lekë nga nëna e tij.

16.5 Subjekti, në përgjigje të Pyetësorit nr. 2, ndër të tjera, ka deklaruar: [...] *duke qenë eksperiencia e parë, kur jam shprehur për burimin e të ardhurave të apartamentit në përcaktimin “pjesërisht nga kursimet familjare”, kam pasur parasysh edhe pjesën financiare të nënës time dhe vëllait, duke i përfshirë si të ardhura nga kursimet familjare [...]*.

16.6 Komisioni, në vijim ka analizuar burimet e pasurisë si vijon:

16.7 (i) Lidhur me burimin kursime familjare, në përgjigje të Pyetësorit nr. 2, subjekti ka sqaruar se me termin “kursimet familjare”, ka përfshirë shumën 10.000 euro, të paguar prej tij në datën **.7.2010, si dhe kontributin e nënës së tij në shumën 600.000 lekë. Sa i takon shumës 10.000 euro të paguar, në datën **.7.2010, subjekti ka sqaruar se e ka burimin te depozita në emër të nënës së tij, ***.***, pranë Bankës ***.***, çelur prej saj në datën **.11.2009, në vlerën 10.000 euro, e cila ka qenë krijuar nga kursimet e subjektit të rivlerësimit me bashkëshorten.

² Lidhur me ndryshimin e çmimit nga 54.000 euro në 50.000 euro, subjekti ka dhënë shpjegime gjatë hetimit administrativ të Komisionit.

³ Referohuni procesverbalit të përcjellë nga ILDKPKI me shkresën nr. *** prot., datë **.6.2021.

16.7.1 Komisioni, në vlerësim përfundimtar të çështjes, nga analiza financiare për krijimin e shumës 10.000 euro, e cila ka shërbyer si burim për pagesën e kështit të apartamentit në datën **.7.2010, nuk ka konstatuar problematika.

16.8 *(ii) Lidhur me burimin “kontribut i nënës” në shumën 600.000 lekë*, që ka shërbyer për pagesën e kështit prej 10.000 euro në datën **.4.2011, Komisioni, për të verifikuar mundësinë financiare të nënës së subjektit për të krijuar shumën 600.000 lekë, ka kryer analizën financiare deri në fund të vitit 2010, duke përdorur metodologjinë kumulative. Nga analiza ka rezultuar se nëna e subjektit ka pasur mjaftueshëm të ardhura të ligjshme për të krijuar shumën 600.000 lekë.⁴

16.9 *(iii) Lidhur me burimin ndihmesë e vëllait nga punësimi në Itali, në shumën 7.000 euro*, Komisioni, pasi ka konstatuar se vëllai i subjektit, shtetasi ***.***, ka blerë një apartament në Durrës në vlerën 50.000 euro, dhe për këtë apartament deri në datën **.3.2011 ka paguar shumën totale 49.000 euro⁵, ka kryer analizën financiare për periudhën **.3.2011 deri në **.8.2011, për të verifikuar mundësinë e vëllait të subjektit për të mbuluar me burime të ligjshme shumën 7.000 euro, dhënë subjektit. Nga analiza përfundimtare ka rezultuar një vlerë negative e vëllait në shumën prej -1.668 euro.

16.9.1 Lidhur me këtë pamjaftueshmëri, Komisioni ka arsyetuar se: [...] *Duke qenë se balanca negative prej 1.668 euro nuk është një vlerë e konsiderueshme dhe në konsideratë të faktit kjo analizë e vëllait të subjektit, i cili nuk ka qenë subjekt deklarues, është një analizë me rezervë bazuar vetëm në të dhënat që Komisioni dispononte, në respektim të parimit të proporcionalitetit, shuma 7.000 euro, e dhënë nga vëllai i tij, është konsideruar si e ardhur e ligjshme në analizën përfundimtare të subjektit, e cila ka shërbyer si burim për blerjen e apartamentit të subjektit të rivlerësimit [...].*

16.10 *(iv) Lidhur me burimin ndihmesë e prindërve të bashkëshortes*, ka rezultuar se në shpjegimet e dhëna në ILDKPKI, në shkurt të vitit 2016, subjekti ka deklaruar se: *vlera monetare e ndihmës prej tyre ka qenë 1.500.000 lekë. Sqaroj se një pjesë e kësaj shumë, prej 7.000 euro, janë derdhur nga vjehri ose vjehrra në llogarinë e djalit tim, ***.*** Lidhur me mundësinë financiare të prindërve të bashkëshortes, subjekti në ILDKPKI ka deklaruar se prindërit e bashkëshortes kanë aktivitet privat prej vitit 1996.*

16.10.1 Ndërsa, në përgjigje të Pyetësorit nr. 2, subjekti ka deklaruar se: [...] *Vlera e kontributit të prindërve të bashkëshortes, në shumën prej 11.000 euro ose 1.500.000 lekë, është dhënë përgjatë vitit 2010, por edhe gjatë vitit 2011. Sqaroj lidhur me deklarinë në ILDKPKI në vitin 2016, kur jam shprehur se shuma prej 7.000 euro, e derdhur në llogarinë e djalit tim në datë **.4.2013, nga prindërit e bashkëshortes, përbënte një pjesë të ndihmës për apartamentin, ai përcaktim më rezulton një pasaktësi në kohë dhe në qëllimin për të cilin është transferuar, duke krijuar për rrjedhojë një konfuzion në shumën totale të kontributit të prindërve të bashkëshortes, por që në fakt ka qenë ndihmesë për arredimin e apartamentit [...].*

16.10.2 Në përgjigje të Pyetësorit nr. 3, subjekti deklaroi se si burim i krijimit të shumës prej 11.000 euro/1.500.000 lekë, dhënë nga prindërit e bashkëshortes, kanë qenë të ardhurat nga shitja e apartamentit të tyre në vitin 1997, sipas kontratës nr. **** rep., ** kol., datë **.1.1997, në

⁴ Referohuni analizës financiare të Komisionit në f. 13, të rezultateve të hetimit.

⁵ Referuar analizës financiare të Komisionit, duket se shtetasi ***.***, me të ardhurat e dokumentuara në dosje, rezulton me pamundësi financiare për të investuar në këtë pasuri. Nga aktet rezulton se shtetasi ***.***, dhe bashkëshortja e tij e kanë shitur këtë pasuri me kontratën e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë **.10.2016, në vlerën 35.000 euro, shtetasi z. ***.***, dhe kjo shumë është depozituar në llogarinë e znj. ***.***, në *** Bank.

vlerën 1.600.000 lekë. Sipas subjektit, pas përfitimit të kësaj shume, vjehri i subjektit e ka dhënë atë borxh tek miku i tij, ***.***, pa ndonjë dokument shkresor të kohës dhe ky i fundit ia ka kthyer borxhin në nëntor të vitit 2010⁶.

16.10.3 Komisioni, lidhur me këtë burim, ka arsyetuar se në kushtet kur prindërit e bashkëshortes së subjektit nuk kanë qenë subjekte deklaruese, e për rrjedhojë, nuk kanë pasur detyrimin e dokumentimit apo deklarimit të huas së dhënë e të marrë prej shtetasit ***.***, si dhe në kushtet kur shuma prej 11.000 euro/1.500.000 lekë, dhënë nga babai i bashkëshortes së subjektit është përdorur nga subjekti për blerjen e apartamentit me sip. 105 m², përpara fillimit të detyrës, Komisioni i është referuar deklarimeve të subjektit gjatë hetimit administrativ dhe akteve shkresore të paraqitura prej tij, të cilat përputhen edhe me periudhat e likuidimit të çmimit të blerjes së pasurisë. Për rrjedhojë, shuma prej 11.000 euro/1.500.000 lekësh, dhënë prej prindërve të bashkëshortes, në përfundim të hetimit administrativ është konsideruar si burim i ligjshëm për blerjen e pasurisë objekt verifikimi.

16.11 (v) Lidhur me mundësinë e prindërve të bashkëshortes për t'i kaluar djalit të subjektit shumën 7.000 euro, në datën **.4.2013, Komisioni, bazuar në të dhënat e administruara gjatë hetimit ka kryer analizën financiare, sipas të cilës ka rezultuar se prindërit e bashkëshortes nuk kanë pasur mjaftueshëm të ardhura për të justifikuar shumën prej 7.000 euro. Për rrjedhojë, kjo shumë nuk është përfshirë si e ardhur e ligjshme në analizën financiare të subjektit për vitin 2013.

16.12 Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni ka kryer analizën financiare përmbledhëse për periudhën para fillimit të detyrës 1.1.2005 - 20.6.2014, nga ku duket se subjekti nuk ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të krijuar pasuritë e deklaruara, apartamentin, garazhin, likuiditetet në bankë dhe gjendjen *cash* në banesë, si dhe për të kryer të gjitha shpenzimet e evidentuara të kësaj periudhe, për shkak të një balance negative prej - 1.390.354 lekë. Sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i është kërkuar të japë sqarime e dokumente në lidhje me këtë konstatim.

16.13 Në vijim, pasi ka administruar pretendimet dhe provat e depozituara nga subjekti pas kalimit të barrës së provës, Komisioni ka rishikuar analizën financiare për periudhën para detyrës, nga ku rezultoi një balancë negative në shumën 80.269 lekë, e cila nuk u konsiderua penalizuese për subjektin e rivlerësimit.

17. Komisioneri Publik, lidhur me disa nga burimet e krijimit të pasurisë *apartament me sipërfaqe 105 m²*, shitja e të cilit ka shërbyer si burim krijimi për pasurinë *depozitë bankare në shumën 5.000.000 lekë*, deklaruar në D-Vett., konstaton se:

17.1 *Lidhur me burimin “kontribut i nënës”, në shumën 600.000 lekë, vërejmë:*

(i) Ky burim krijimi nuk është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në D-Vett. dhe as në deklaratën para fillimit të detyrës në vitin 2014;

(ii) Referuar shkresave të ISSH-së me nr. *** prot. dhe nr. *** prot., datë **.6.2022, rezulton se të ardhurat e znj. ***.***, nga pensioni për periudhën 2003 – prill 2011, janë rreth 700.000 lekë. Kjo shumë së bashku me të ardhurat e pretenduara nga shitja e tokës në bashkëpronësi të

⁶ Për të provuar këtë pretendim, subjekti ka depozituar deklaratën noteriale nr. *** rep., *** kol., datë **.8.2022, me deklarues z. ***.*** dhe z. ***.***, ku deklarohet se z. ***.***, në janar të vitit 1997, për qëllime të zhvillimit të biznesit i ka dhënë z. ***.***, borxh shumën prej 1.500.000 në dorë, shumë e cila është pretendohet se është kthyer prej këtij të fundit tërësisht në nëntor 2010.

nënës së subjektit⁷, e dokumentuar në aktet në dosje, është e pamjaftueshme për të mbuluar shpenzimet e jetesës për një person për këtë periudhë, si dhe shumën 600.000 lekë, dhënë subjektit të rivlerësimit⁸.

17.2 *Lidhur me burimin ndihmesë e vëllait nga punësimi në Itali, në shumën 7.000 euro vërejmë:*

- (i) Në D-Vett., subjekti ka deklaruar si burim krijimi ndihmesë nga vëllai i punësuar në Itali, pa specifikuar vlerën e kësaj ndihme;
- (ii) Në deklaratën para fillimit të detyrës të vitit 2014, subjekti nuk e ka deklaruar këtë burim krijimi;
- (iii) Referuar analizës financiare të kryer nga Komisioni, për të vlerësuar mundësinë e z. ***.***, për të mbuluar me burime të ligjshme shumën 7.000 euro dhënë subjektit, ka rezultuar një pamjaftueshmëri në vlerën -1.668 euro. Shpenzimet e jetesës për familjen e z. ***.***, në këtë analizë nuk janë llogaritur në përputhje me përbërjen familjare dhe me të dhënat e Eurostat-it⁹, çka do të çonte në një pamjaftueshmëri, në një vlerë më të madhe se ajo e konstatuar nga Komisioni.

17.3 *Lidhur me burimin ndihmesë e prindërve të bashkëshortes në shumën 1.500.000 lekë për blerje apartamenti dhe 7.000 euro për arredim, vërejmë:*

- (i) Në D-Vett., dhe në deklaratën para fillimit të detyrës të vitit 2014, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burim krijimi për apartamentin me sip. 105 m:² ndihmesë nga prindërit e bashkëshortes, por në asnjërën prej këtyre deklaratave, nuk ka deklaruar sa është shuma e ndihmës së dhënë prej tyre.
- (ii) Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet e tij lidhur me vlerat dhe kohën e dhënies të këtyre shumave nga prindërit e bashkëshortes, ka qenë kontradiktor dhe i pasaktë. Në procesverbalin e ILDKPKI-së, datë **.2.2016, subjekti ka deklaruar se vlera monetare e ndihmës ka qenë 1.500.000 lekë, dhe ka sqaruar se një pjesë e kësaj ndihme prej 7.000 euro janë derdhur në bankë nga vjehri ose vjehrra në llogarinë e djalit të tij, ***.***, në vitin 2013, ndryshe nga sa ka deklaruar gjatë hetimit administrativ se shuma 1.500.000 i është dhënë gjatë viteve 2010-2011, ndërsa shuma 7.000 euro në vitin 2013.
- (iii) Subjekti i rivlerësimit ka qenë kontradiktor dhe i pasaktë dhe lidhur me burimin e të ardhurave që kanë shërbyer për dhënien e shumës 1.500.000 lekë. Në ILDKPKI, në procesverbalin e datës **.2.2016, ka deklaruar se prindërit e bashkëshortes kanë aktivitet privat prej vitit 1996, ndërsa gjatë hetimit administrativ ka deklaruar si burim të ardhurat nga shitja e apartamentit të tyre në vitin 1997, sipas kontratës nr. *** rep., nr. ** kol., datë *.1.1997.
- (iv) Sa i takon të dhënave financiare të prindërve të bashkëshortes nga aktet e administruara në dosje, vërejmë se pas shitjes së apartamentit në vitin 1997, ata kanë kryer një investim për ndërtimin e një objekti tregtar hotel/restorant në qytetin e Sarandës¹⁰, në një vlerë të

⁷ Referuar akteve të paraqitura nga subjekti, kontratë shitblerje nr. *** rep., nr. *** kol., në vlerën 200.000 lekë, dhe deklaratës noteriale nr. *** rep., datë **.10.2004, në vlerën 200.000 lekë, konstatohet se pjesa takuese e nënës së subjektit për të dyja këto akte është sa ¼, pra në vlerën 100.000 lekë.

⁸ Referuar akteve në dosje të Komisionit, konstatohet se nëna e subjektit, në vitin 2007, ka blerë një apartament në shumën 4.000.000 lekë, ku si burim deklarohen të ardhura nga shitja e një tjetër apartamenti, në shumën 3.700.000 lekë dhe kursime.

⁹ Referuar të dhënave të Eurostat-it, shpenzimet e jetesës në shtetin italian për një familje të përbërë nga 4 anëtarë, për 6 muaj, llogariten në vlerën rreth 10.000 euro.

¹⁰ Pronësia e këtij objekti është pjesë e hetimit administrativ të Komisionit.

konsiderueshme. Prindërit e bashkëshortes së subjektit kanë marrë disa herë kredi bankare në bankat e nivelit të dytë, në funksion të aktivitetit të tyre tregtar. Gjithashtu, dhe të ardhurat e realizuara prej tyre nga ushtrimi i aktivitetit tregtar, referuar të dhënave të administruara në dosjen e ILDKPKI-së deri në vitin 2013, kur është dhënë dhe shuma 7.000 euro, janë në një masë të tillë që nuk mundësojnë mbulimin e shpenzimeve për jetesë, kredi dhe për t'i dhënë subjektit dhe personit të lidhur me të, shumat 1.500.000 lekë dhe 7.000 euro.

17.4 Në këto rrethana fakti, në kushtet kur subjekti i rivlerësimit as në Deklaratën “Vetting” dhe as në deklaratën para fillimit të detyrës, nuk ka specifikuar dhe/ose deklaruar vlerat e shumave të dhëna si kontribut nga nëna, vëllai dhe prindërit e bashkëshortes, si dhe ka deklarime kontradiktore lidhur me burimin e krijimit dhe kohën e marrjes së ndihmës financiare nga prindërit e bashkëshortes, pamundësohet dhe kontrolli i burimit të deklaruar “*kursime familjare*”, me kontribut të ardhurat e subjektit të rivlerësimit dhe të bashkëshortes.

17.5 Në përmbledhje të sa më sipër, Komisioneri Publik vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk rezulton i besueshëm në kriterin e kontrollit të pasurisë, pasi është në kushtet e deklarimit kontradiktor, të pasaktë dhe të pamjaftueshëm dhe çon institucionet e rivlerësimit në pamundësi për të verifikuar se cilat ndër deklaratimet e subjektit të rivlerësimit pasqyrojnë situatën e vërtetë faktike lidhur me burimin e krijimit të pasurisë së tij.

17.6 Në përfundim të kontrollit të pasurisë, Komisioneri Publik vlerëson se rrethanat e dala nga hetimi administrativ mbi këtë kriter duhet të vlerësohen në zbatim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

III.B. Lidhur me kontrollin e kriterit të figurës

18. Komisioni, bazuar në nenin Dh të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, ka administruar raportin e kontrollit të figurës me nr. *** prot., datë **.10.2017, përparitur nga DSIK-ja për subjektin e rivlerësimit, z. Llaho. Në vijim, Komisioni ka kërkuar përditësimin e të dhënave nga organet ligjzbatuese, si dhe ka verifikuar informacionet konfidenciale pranë këtyre organeve, duke administruar për këtë qëllim dhe dosjet përkatëse të disa procedimeve penale, trajtuar më tej nga Komisioni në kriterin e të aftësive profesionale. Referuar arsytimit të vendimit (f. 56), Komisioni ka trajtuar katër (4) çështje penale, procedimi penal nr. ***/2019, procedimi penal nr. ***/2018, çështjet penale lidhur me shtetasin ***.***, si dhe procedimi penal nr. ***/2021.

18.1 Komisioneri Publik vlerëson se shkeljet e konstatuara në dosjet penale të trajtuara në kuadër të vlerësimit të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, në një vlerësim tërësor të çështjes, marrin kuptim dhe peshë domethënëse, në konsideratë të informacioneve që rezultojnë nga agjencitë ligjzbatuese.

18.2 Në vlerësimin e Komisionerit Publik, në konsideratë të jurisprudencës së Kolegjit¹¹, nga analiza e shkeljeve të konstatuara dhe informacioneve të përcjella nga agjencitë ligjzbatuese, përftohen indicie dhe perceptime të rëndësishme se integriteti i subjektit të rivlerësimit, sipas parashikimit të nenit 75, pika 3 e ligjit nr. 96/2016, të ndryshuar, do të duhej të konsiderohej me mangësi.

¹¹ Referohuni vendimit (JR) nr. 16/2021 të Kolegjit, prg. 92.

18.3 Në analizë të akteve të administruara, në gjendjen që ato janë përcjellë pranë Komisionerit Publik, lidhur me tre (nga katër), procedimet penale të trajtuara nga Komisioni në kriterin e aftësive profesionale, rezultojnë faktet dhe rrethanat si më poshtë.

19. Procedimi penal nr. ***, datë **.6.2019

19.1 Nga aktet e fashikullit të procedimit penal, rezulton se Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, në datën **.6.2019¹², ka regjistruar procedimin penal nr. ***/2019, për veprat penale: “*Vrasja në rrethana të tjera cilësuese*”, e kryer në bashkëpunim, me pasojë viktimën shtetasin ***.***, e mbetur në tentativë ndaj shtetasit ***.*** dhe për veprën “*Mbajtje pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe municionit*”, parashikuar nga nenet 79/dh-25 dhe 278/1 të K. Penal.¹³

19.2 Hetimin e çështjes e ka marrë dhe drejtuar subjekti i rivlerësimit, i cili në datën **.6.2019, në kolonën e regjistrimit të autorëve të dyshuar për veprën penale, ka urdhëruar regjistrimin e emrit të personit që i atribuohet vepra penale shtetasit ***.*** (***.); ***.***; ***.***; dhe ***.***, si persona të dyshuar për veprat penale të sipërcituara. Subjekti i rivlerësimit, pasi ka vlerësuar se: *ka të dhëna të mjaftueshme dhe dyshime në nivelin e provës që tregojnë...* se këta shtetas janë autorët e ngjarjes ku është vrarë shtetasi ***.*** dhe plagosur shtetasi ***.***, i është drejtuar gjykatës me kërkesën për vleftësimin e ligjshëm të arrestit në flagrancë dhe caktimin e masës arrest në burg, për shtetasit ***.***, ***.***, ***.***. Ndërsa shtetasi ***.*** (***.) nuk është gjendur.

19.3 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. ***, datë **.6.2019, ka vendosur: (i) Vleftësimin si të ligjshëm të arrestit në flagrancë të shtetasit ***.***; ***.***; ***.***; dhe (ii) caktimin e masës së sigurisë “arrest me burg” si persona të dyshuar për veprat penale “*Vrasja në rrethana të tjera cilësuese*”, e kryer në bashkëpunim, me viktimitë nga vepra penale, shtetasin ***.***, dhe e mbetur në tentativë ndaj shtetasit ***.***, si dhe për veprën “*Mbajtje pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe municionit*”, parashikuar nga nenet 79/dh, 25 dhe 278/1 të K. Penal. Ky vendim ka marrë formë të prerë, pasi nuk është ankimuar nga palët.

19.4 Në vijim të ecurisë së hetimit penal¹⁴, subjekti i rivlerësimit ka vendosur zgjatjen e afatit hetimor në dy raste, (i) në datën **.9.2019, për një periudhë 3-mujore (deri në datën **.12.2019), me arsyetimin për nevojën e kryerjes së disa veprimeve shtesë, si pyetjen e personave që kanë dijeni për ngjarjen, administrimin e të dhënave shkencore për të gjitha aktet e ekspertimit si dhe veprime të tjera¹⁵; (ii) në datën **.12.2019, për një periudhë 1-mujore (deri në datën **.1.2020), me arsyetimin se nga hetimet e deritanishme, të pandehurit nuk kanë zgjedhur mbrojtës, është e

¹² Referohuni shkresës nr. *** prot., datë **.10.2022.

¹³ Në datën **.6.2019, rreth orës 14.43, Policia Gjyqësore është njoftuar nga Salla Operative e Drejtorisë së Policisë Vlorë se në fshatin ***, Njësia Administrative ***, Bashkia Selenicë, janë qëlluar me armë zjarri disa shtetas. Nga kjo ngjarje ka gjetur vdekjen shtetasi ***.***, me detyrë administrator i Njesisë Administrative *** të Bashkisë Selenicë.

¹⁴ Nga aktet referohet se është mbajtur procesverbal i këqyrjes dhe marrjes së të dhënave kompjuterike nga sistemi TIMS i shtetasit ***.*** (**.), si dhe është dërguar kërkesa në gjykatë për caktimin e masës arrest në burg të shtetasit ***.*** (**.), e cila është pranuar nga Gjykata e rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. ***, datë **.6.2019. Nga subjekti është urdhëruar ekzekutimi i vendimit nr. *** datë **.6.2016.

¹⁵ Gjatë muajit tetor 2019, janë mbajtur procesverbale të deklarimeve të shtetasve ***.***, dhe ***.***, si dhe është kërkuar vënia në përgjim të telekomunikacioneve; (ii) Gjatë muajit nëntor 2019, është kërkuar vleftësimi i vendimit dhe lejimin e përgjimit. Janë mbajtur procesverbale të deklarimeve të shtetasve ***.***, ***.***, ***.***, është mbajtur procesverbal i shtetasit ***.***, për ankimin e të dëmtuarit nga vepra penale. Është urdhëruar këqyrja e dokumentacionit që disponon spitali Vlorë për trajtimin mjekësor të shtetasit ***.***, si dhe kryerja e ekspertimit mjeko-ligjor të shtetasit ***.***. Janë administruar akt-ekspertimi biologjik, janë mbajtur procesverbale të kërkimit të personit ***.***; (iii) Më datë **.12.2019, është mbajtur procesverbal i shtetasit ***.***, për marrjen e të dhënave nga persona, ndaj të cilit zhvillohen hetime, i cili ka deklaruar se shpjegimet do t'i japë me një avokat.

nevojshme që organi i akuzës të procedojë me caktimin e një mbrojtësi kryesisht, si dhe me qëllim komunikimin e akuzës, pyetja në cilësinë e të pandehurit, si dhe paraqitja para gjykatës e kërkesës për të vendosur deklarinimin e ikjes dhe caktimin e mbrojtësit kryesisht të të pandehurit ***.***.

19.5 Subjekti i rivlerësimit, në datën **.12.2019, ka urdhëruar ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale për procedimin penal nr. ***/2019 nga “Vrasja në rrethana të tjera cilësuese”¹⁶, e kryer në bashkëpunim, me viktimë nga vepra penale shtetasin ***.***, dhe mbetur në tentativë ndaj shtetasit ***.***, në veprën penale “Vrasja nga pakujdesia”¹⁷, në dëm të shtetasit ***.***, parashikuar nga neni 85 i KP, në ngarkim të shtetasit ***.*** (**). Në vijim, në datën **.12.2019, subjekti i rivlerësimit ka vendosur njoftimin e shtetasve të tjerë për përfundimin e hetimeve, konkretisht, të pandehurit ***.***, dhe ***.***, për akuzën e “Kanosje”, e kryer në bashkëpunim në dëm të shtetasit ***.***, dhe “Moskallëzim krimi”. Për të pandehurin ***.*** ka vendosur njoftimin për përfundimin e hetimeve, për akuzën “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe municionit”, parashikuar nga neni 278/1 i K. Penal., si dhe “Kanosja”, e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 84 e 25 të K. Penal.

19.6 Më datë **.12.2019, subjekti i rivlerësimit i është drejtuar gjykatës, me kërkesën për shuarjen e masës “arrest në burg” dhe caktimin e një mase tjetër sigurimi, atë “të arrest në shtëpi”, për shtetasit ***.***, ***.***, dhe ***.***, me arsyetimin se: “rezulton se më datë 15.6.2019, Gjykata ka vendosur masën arrest në burg... deri në datën e sotme, nga zbatimi i masës arrest në burg, kanë kaluar më shumë se 6 muaj”.

19.7 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. ***, datë **.12.2019, i formës së prerë¹⁸, ka vendosur rrëzimin e kërkesës të subjektit të rivlerësimit për shuarjen e masës arrest në burg, si të pabazuar në ligj dhe prova, me arsyetimin, ndër të tjera, se: [...] (i) *Në kërkesën e Prokurorisë pretendohet se ka ndryshuar cilësimi juridik i faktit penal dhe, më datë **.12.2019, këtyre shtetasve janë formuluar akuzat përkatëse, të komunikuara me datë **.12.2019. Pretendohet se deri në ditën e dorëzimit të akteve në gjykatë, kanë kaluar me shumë se 6 muaj, për arsye të pamundësisë objektive?!; (ii) Në vijim të veprimeve procedurale është i njëjti fakt penal. E pyetur nga Gjykata, Prokuroria është shprehur se nuk ka kërkuar zgjatjen e afateve të hetimit. Rezulton se i akuzuari kryesor, ***.***, është larguar dhe ende nuk është gjetur nga policia.; (iii) Gjykata konstaton se kërkesa e prokurorit është e pabazuar në ligj dhe prova. Është e nevojshme të zbatohen të gjitha veprimet procedurale, pasi fakti penal ka të bëjë me një ngjarje me pasoja të pakthyeshme, si dhe lënia e lirë, goftë dhe me arrest shtëpie për të akuzuarit, pa u sqaruar mirë fakti penal e autorët, do të sillte rrezik për ngjarje penale të njëjta (tashmë nga palët për vetëgjyqësi) [...].*

19.8 Në vijim, referuar rezultateve të hetimit të Komisionit, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka ndërmarrë edhe disa veprime në funksion të këtij hetimi penal¹⁹ dhe, në përfundim, ka vendosur dërgimin për gjykim të procedimit penal nr. ***/2019, në ngarkim të të pandehurve: (i)

¹⁶ Neni 79 i K. Penal, “Vrasja në rrethana të tjera cilësuese” - Vrasja me dashje e kryer: a) ndaj të miturit; b) ndaj personit me mangësi fizike ose psikike, të sëmurë rëndë ose shtatzënë, kur cilësitë e viktimit janë të dukshme ose të njohura; c) shfuqizuar; ç) ndaj kallëzuesit, dëshmitarit, të dëmtuarit ose palëve të tjera ndërgjyqëse; d) më shumë se një herë; dh) kundër dy ose më shumë personave; e) në mënyrë të tillë që i shkakton mundime të veçanta viktimit; ë) në mënyrë të rrezikshme për jetën e shumë personave, dënohet me burgim jo më pak se njëzet vjet ose me burgim të përjetshëm.

¹⁷ Neni 85 i K. Penal “Vrasja nga pakujdesia” - Vrasja e kryer nga pakujdesia dënohet me gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet.

¹⁸ Vendimi ka marrë formë të prerë me vendimin nr. **, datë **.1.2020, të Gjykatës së Apelit Vlorë, e cila ka vendosur “Mospranimin e ankimit”.

¹⁹ Nga sa rezulton, në datë **.12.2019, subjekti ka vendosur njoftimin për përfundimin e hetimeve ***.*** (**). Në datën **.1.2020, DVP Vlorë, ka dërguar akt-ekspertimi nr. ***, datë **.12.2019, dhe provën...; Në datën **.1.2020, subjekti i rivlerësimit ka urdhëruar bashkimin e provave materiale me fashikullin e procedimit nr. ***/2019.

. (**), i akuzuar për veprat penale: “Vrasja nga pakujdesia”, “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve, luftarake”, në ambiente publike, dhe “Kanosja” në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 85, 278/1 dhe 84 dhe 25 të K. Penal, i hetuar me masën e sigurimit personal “Arrest në burg” (e paekzekutuar); (ii) ***.***, i akuzuar për veprat penale të “Prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armëve luftarake”, në ambiente publike dhe “Kanosjes” në bashkëpunim, parashikuar nga 278/1 dhe 84 dhe 25 të K. Penal, i hetuar me masën e sigurimit personal “Arrest në burg”; (iii) ***.***, ***.***, të akuzuar për veprat penale “Moskallëzim të krimi” dhe “Kanosja” e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 300 dhe 84 e 25 të K. Penal, të hetuar me masën e sigurimit personal “Arrest në burg”.

19.9 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. ***, datë **.2.2020, të gjyqtarit paraprak, ndër të tjera, ka vendosur: (i) kalimin e çështjen për kompetencë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë (Dhomës Penale), me qëllim gjykimin në themel të procedimit penal nr. ***/2019, në ngarkim të pandehurit ***.***, i akuzuar për kryerjen e veprave penale të “Vrasjes nga pakujdesia” dhe “Prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armëve luftarake”, parashikuar nga nenet 85 dhe 278/1 i K. Penal, si dhe në ngarkim të pandehurit ***.***, i akuzuar për kryerjen e veprës penale të “Prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armëve luftarake”, parashikuar nga neni 278/1 i K. Penal; (ii) Pushimin e akuzës në ngarkim të të pandehurve ***.*** (***) dhe ***.***, për veprën penale “Kanosja” në bashkëpunim, parashikuar nga neni 84 e 25 i K. Penal, për shkak të tërheqjes së ankimit nga ana e personit të dëmtuar ***.***; (iii) Pushimin e procedimit penal nr. ***/2019 në ngarkim të pandehurve ***.*** dhe ***.***, të akuzuar për veprën penale “Kanosja” në bashkëpunim, parashikuar nga neni 84/25 K. Penal dhe “Moskallëzim krimi”, parashikuar nga neni 300 i K. Penal, për shkak të tërheqjes së ankimit nga ana e personit të dëmtuar, si dhe për shkak se fakti nuk përbën veprë penale.

19.10 Komisioni, ndër të tjera, i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të japë sqarime të bazuara në prova, lidhur me konstatimin dhe arsyet për: (i) Ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale të procedimit penal nr. ***/2019; (ii) Kërkesën e datës **.12.2019, paraqitur nga subjekti për shuarjen e masës së sigurimit “arrest në burg” dhe caktimin e një mase tjetër, atë të “arrest në shtëpi”, për shtetasit ***.***, ***.***, ***.***, të cilën Gjykata e ka konstatuar si të pabazuar në ligj dhe prova.

19.11 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të rezultateve të hetimit, ndër të tjera, ka parashtruar se: [...] *Në lidhje me ndryshimin e cilësimit juridik të veprës, bëj me dije se dispozita procedurale sipas nenit 287 të K. Pr. Penale, parashikon se prokurori gjatë fazës së hetimit paraprak, pas administrimit të provave dhe shqyrtimit të tyre mund të urdhërojë ndryshimin e cilësimit juridik të veprës... Mbi mospranimin e kërkesës për shuarjen e masës së sigurisë arrest me burg, në analizë të parashtrimeve të vendimit nr. ***, datë **.12.2019, konstatohen përcaktime të gabuara të dispozitave procedurale. Vendimi rezulton i paarsyetuar dhe gjyqtari përkatës nuk ka parashtruar argumente apo analizë ligjore, veçse ka pasqyruar dispozitat e ligjit procedural, madje edhe pasqyrimin e dispozitave e ka bërë me referenca të gabuara [...].*

19.12 Komisioni, në vlerësim përfundimtar të çështjes, ka konstatuar se lidhur me kërkesën e subjektit për shuarjen e masës “arrest në burg”, ka qenë një vlerësim personal bazuar në një interpretim ligjor sipas këndvështrimit dhe bindjes së tij, për të cilën gjykata ka pasur një interpretim ndryshe. Komisioni ka vlerësuar se kërkesa e subjektit nuk ka pasur asnjë pasojë negative në zgjidhjen përfundimtare të çështjes.

20. Komisioneri Publik ndan qëndrim të ndryshëm me përfundimin e Komisionit për vlerësimin e rastit. Në analizë të situatës faktike, përshkruar si më sipër, rezulton se prej datës së vendimit gjyqësor, nr. ***, datë **.6.2019, momenti i vleftësimit të arrestit në flagrancë dhe caktimit të masës së sigurisë “arrest me burg” ndaj shtetasve të dyshuar në kuadër të procedimit penal nr. ***/2019, e deri në datën **.2.2020, moment kur gjyqtari paraparak me vendimin nr. ***, ka vendosur kalimin e çështjes për gjykim me akuzat përkatëse, kanë kaluar më shumë se 8 muaj.

20.1 Gjatë kësaj periudhe, veprimet hetimore të ndërmarra nga subjekti i rivlerësimit kanë rezultuar jo efektive, të paplota dhe jo të gjithanshme. Konstatimi i mungesës së dilijencës për të kryer në afate të arsyeshme veprimet hetimore të duhura dhe realisht të lidhura me akuzën në ngarkim të të arrestuarve, ka pasoja në ngritjen e akuzës duke kërkuar edhe ndryshimin e cilësimit juridik të veprave penale. Sa më lart konstatuar, bazohet në arsyetimin e vendimit gjyqësor nr. ***/2019, ku argumentohet, se mbi të njëjtin fakt penal dhe prova, në këtë periudhë kohore nuk ka pasur asnjë të dhënë thelbësore të dalë nga një veprimtari hetimore e plotë, që të çonte prokurorin e çështjes, në rastin konkret subjektin e rivlerësimit, në cilësimin ndryshe të veprës penale.

20.2 Ndryshimi i cilësimit juridik të veprës penale ka passjellë dhe kërkesën e subjektit të rivlerësimit për ndryshimin e masave të sigurisë, si rezultat i afateve të kohëzgjatjes së paraburgimit, afate të cilat me cilësimin e ri të veprave penale, janë në një shtrirje kohore prej 6 muaj, sipas nenit 263/1/b të K. Pr. Penale, duke pranuar edhe vetë subjekti se, në këtë rast, ka pasur tejkalime të afateve, për arsye të pamundësisë objektive, por pa i argumentuar ato.

20.3 Referuar këtyre të dhënave, Komisioneri Publik vlerëson se mangësitë e vërejtura, bien ndesh me nënindikatorët e parashikuar në nenin 73, pikat 2 e ligjit nr. 96/2016, të ndryshuar, dhe duhen të merren në konsideratë nga Kolegji në vlerësimin tërësor të çështjes së subjektit të rivlerësimit, pasi shkeljet e konstatuara në dosjet penale të trajtuara në këtë kriter, marrin kuptim dhe peshë domethënëse, në konsideratë edhe të informacioneve që rezultojnë nga agjencitë ligjzbatuese.

21. Procedimi penal nr. *, datë **.3.2018²⁰**

21.1 Nga aktet e administruara, rezulton se në datën **.3.2018, pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë, është regjistruar kallëzimi penal nr. ***, referuar nga Komisariati i Policisë Vlorë, për ngjarjen e ndodhur në datën **.3.2018, ku shtetasi ***.*** ka gjetur vdekjen si pasojë e rënies së një vetrate duralumini nga pallati i ndërtuar nga subjekti “****”.

21.2 Subjekti i rivlerësimit, në datën **.3.2018, ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal nr. *** për veprën penale “Shkelja e rregullave të mbrojtjes në punë”, parashikuar në nenin 289 të K. Penal²¹, dhe gati 10 muaj më pas, në datën **.1.2020, subjekti i rivlerësimit urdhëron ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale dhe regjistrimin e emrit të shtetasit ***.***, punëtorit që ka ekzekutuar montimin, si person i dyshuar për veprën “Vrasja nga pakujdesia”, në

²⁰ Lidhur me këtë procedim ka pasur dhe një informacion në media: https://***-***.*/2020/02/**/vdiq-se-i-ra-vevratat-e-xhamit-ne-koke-prokurori-prej-2-vitesh-zvarrit-hetimin-kercenon-familjaret/.

²¹ Në lidhje me këtë procedim penal, Komisioni ka konstatuar se janë kryer disa veprime hetimore. Me vendim datë **.5.2019, subjekti i rivlerësimit ka vendosur kryerjen e aktit të ekspertimit teknik të ndërtimit me ekspert *** dhe ***, brenda një afati prej 15 ditëve. Më pas, prokurori ka zgjatur 4 herë afatet, me nga 30 ditë, me arsyetimin se deri në datën e sotme ekspertimi nuk është kryer, është e nevojshme zgjatja e afatit deri në datën **.6.2019, sipas nenit 185/3 të K. Pr. Penale, duke qenë se kërkimet dhe vlerësimet paraqiten komplekse. Akti i ekspertimit është administruar më datë **.12.2019. Më datë **.11.2019 është administruar ekspertimi mjeko-ligjor i datës **.3.2018, i vdekjes së shtetasit ***.

dëm të shtetasit ***.***, parashikuar nga neni 85 i K. Penal. Regjistrimin e emrave të shtetasve ***.***, në cilësinë e drejtuesit teknik, ***.***, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve dhe ***.***, në cilësinë e kolaudatores, si të dyshuar për veprën penale “Shpërdorim detyre”, parashikuar nga neni 248 i K. Penal.

21.3 Në datën **.3.2020, subjekti i rivlerësimit ka administruar Memo/Kërkesë të datës **.3.2020 nga shtetasi ***.*** (djali i viktimës).

21.4 Në datë **.7.2020, subjekti ka kërkuar pushimin e hetimeve në ngarkim të shtetasit ***.***, për veprën penale “Vrasja nga pakujdesia”, parashikuar nga neni 85 i K. Penal²². Ndërsa për shtetasit ***.*** (**); ***.***; ***.***, subjekti ka dërguar në datën **.7.2020 kërkesën për dërgimin e çështjes në gjykim, të akuzuar për veprën penale “Shpërdorim i detyrës”, parashikuar nga neni 248 K. Penal.

21.5 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. ***, datë **.10.2020, ndër të tjera, ka arsyetuar se: [...] *Në analizë të dispozitave të mësipërme në raport me rrethanat e procedimit në hetim, Gjykata vlerëson se përfundimi i hetimeve dhe paraqitja e kërkesës për gjykimin e procedimit penal kërkon përmbushjen nga ana e prokurorit të disa veprimeve konkrete, pa të cilat kërkesa për gjykim është e pavlefshme.... Në seancën paraprake të pandehurat pretenduan se atyre nuk u është vënë në dispozicion projekti i miratuar nga K.R.T Vlorë, por një projekt tjetër i cili ka parashikuar ndryshime në lidhje me ndarjen e ambienteve na katin e parë, ku ishte montuar vetrata e rënë... Ky pretendim i të pandehurave duhet të hetohet me plotësimin e hetimeve... Nga ana tjetër, prokurori duhet të verifikojë dhe të konkludojë edhe për mundësinë e përgjegjësisë së inxhinierit projektues mbi mangësitë e projektit.*

*Në lidhje me kërkimin e pushimit të çështjes penale në ngarkim të dyshuarit ***.***, për veprën penale “Vrasje nga pakujdesia”, akuzat në ngarkim të pandehurit ***.***, nuk mund të pushohet. Vetëm me përfundimin e hetimeve me plotësimin e tyre nga organi i ndjekjes penale do të mund të nxjerrë në konkluzione në lidhje me përgjegjësinë penale të të dyshuarit si personi që ka kryer veprimet e montimit të vetratës [...].*

21.6 Sa më sipër Gjykata, ka vendosur: (i) Kthimin e akteve të procedimit penal nr. ***, viti 2018 për plotësimin e hetimeve sipas orientimit në pjesën arsyetuese të këtij vendimi, duke caktuar afatin për plotësimin e hetimeve deri në datën **.11.2020, ora 12.00; (ii) Kthimin e akteve prokurorit dhe vazhdimin e hetimeve mbi çështjen penale në ngarkim të personit nën hetim ***.***, për veprën penale “Vrasje nga pakujdesia”, parashikuar nga neni 85 i K. Penal, sipas orientimeve në pjesën arsyetuese të këtij vendimi.

21.7 Nga aktet rezulton se seanca e radhës, është zhvilluar më datë **.1.2021, në të cilën Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. ***, ndër të tjera, ka arsyetuar se: [...] *Në lidhje me veprime apo mosveprime të projektuesit, prokurori është mjaftuar me pranimin e faktit se nuk ka pasur në projektin e miratuar ndonjë projekt të posaçëm për montimin e vetratës dhe nuk ka marrë në shqyrtim mundësinë e përgjegjësisë penale ndaj projektuesit. Po kështu mbi pretendimet e të pandehurave se subjekti ndërtues u ka vënë në dispozicion një projekt me ndryshime, nga ana e organit të akuzës nuk është hetuar. Gjykata vlerëson se nuk ka autoritetin*

²² Subjekti ka arsyetuar, ndër të tjera, se, “... në lidhje me veprimtarinë e shtetasit ***.***, pavarësisht përcaktimit të aktit të ekspertimit, shkak i drejtëpërdretje i rënies së vetratës ka qenë mungesa e murit ndarës dhe mosvendosja e një dere dhe vetrate, e parashikuar në projektin e godinës. Nuk provohet lidhja shkakësore midis veprimtarisë së këtij shtetasi me ardhjen e pasojës së datës **.3.2018, për rrjedhojë nuk mund të formulohet akuzat “vrasja nga pakujdesia”.

dhe diskrecionin të vlerësojë rrethana të tilla dhe të ngrejë akuzë apo t'i imponojë prokurorit ngritjen e akuzave ndaj personave që ai nuk ka përfshirë në procedimin penal [...].

21.8 Në këto rrethana, Gjykata ka vendosur dërgimin për gjykim të procedimit penal nr. ***/2018, në ngarkim të të pandehurave ***.***, ***.***, dhe ***.***, të akuzuar për veprën penale “Shpërdorim i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i K. Penal. Pushimin e çështjes penale në ngarkim të shtetasit ***.***, për veprën penale “Vrasje nga pakujdesia”, parashikuar nga neni 85 i K. Penal.

21.9 Komisioni, për sa më sipër, i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të japë shpjegime, lidhur me konstatimet dhe arsyet e: (i) Ndryshimit të cilësimit juridik të veprës penale të procedimit penal nr. ***/2018; (ii) Faktin se janë paraqitur memorie dhe kërkesa me shkrim nga palët, të cilët kanë kërkuar kryerjen e veprimeve hetimore, por nga aktet në dosje, nuk rezulton që prokurori të jetë shprehur sipas parashikimit të nenit 110 të K. Pr. Penale.

21.10 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të rezultateve të hetimit, sa i takon ndryshimit të cilësimit juridik të veprës penale, është shprehur se ka vepruar sipas nenit 287 të K. Pr. Penale. Subjekti ka parashtruar se Gjykata, si me vendimin nr. ***, datë **.10.2020, për “Kthimin e akteve të procedimin penal nr. ***/2018”, ashtu edhe me vendimin nr. ***, datë **.1.2021, për “Dërgimin e çështjes në gjyq”, nuk ka marrë në analizë aktin procedural “Urdhër për ndryshimin e cilësimit juridik të veprës”, por është mjaftuar me analizën e kërkesave të prokurorit. Më tej, subjekti ka pretenduar se Komisioni ndodhet në kushtet e nenit E/2 të aneksit të Kushtetutës, duke referuar vendimin nr. 33/2021 të Kolegjit, dhe paraqitur shkresën nr. *** prot., datë **.12.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, sipas së cilës çështja ndodhet në gjykim në themel.

21.11 Komisioni, në vlerësimin përfundimtar të çështjes, nuk ka konstatuar elemente që cenojnë aftësitë profesionale apo besimin e publikut, lidhur me faktet e dala në trajtimin e çështjes penale nr. ***/2018 nga subjekti i rivlerësimit.

22. Komisioneri Publik ndan qëndrim të ndryshëm nga Komisioni, pasi në rastin konkret, në dy vendimet gjyqësore të administruara janë konstatuar mangësi të veprimeve hetimore, për evidentimin e subjekteve përgjegjës të ngjarjes. Arsyetimi i subjektit të rivlerësimit se gjykata pas kthimit të akteve, ka pranuar dhe disponuar të njëjtin qëndrim me të, nuk qëndron, referuar dy konstatimeve të verifikueshme në arsyetimet e vendimeve gjyqësore.

22.1 *Së pari*, në drejtim të nënindikatorëve të përcaktuar nga neni 73, pika 2 e ligjit nr. 96/2016, i ndryshuar, mbi *aftësinë e përgjithshme të prokurorit për të ndërmarrë logjikisht hetimin, sipas kërkesave ligjore, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj*, ashtu dhe në drejtim të rezultatit përfundimtar, Gjykata me vendimin nr. ***, datë **.10.2020, ka arsyetuar gjerësisht mbi nevojën e veprimeve hetimore shtesë, që duhen të kryhen nga ana e organit të akuzës²³.

22.2 *Së dyti*, Gjykata edhe në vendimin nr. ***, datë **.1.2021, ka konstatuar sërish mangësi hetimore, duke arsyetuar, ndër të tjera, se *organi i akuzës nuk ka marrë në shqyrtim mundësinë e përgjegjësisë penale ndaj projektuesit. Po kështu mbi pretendimet e të pandehurave se subjekti ndërtues u ka vënë në dispozicion një projekt me ndryshime, nga ana organit të akuzës nuk është hetuar*, duke afektuar kështu dhe nënindikatorin e përcaktuar nga neni 73, pika 3 e ligjit nr. 96/2016, i ndryshuar, mbi cilësinë e analizës dhe argumentimit logjik të prokurorit.

²³ Komisioni ka konstatuar se nga data e regjistrimit të procedimit penal, datë **.3.2018 dhe deri në datën e dërgimit të kërkesës për dërgimin e çështjes në gjykim, çështja ka zgjatur dy vjet e tre muaj.

22.3 Në këto rrethana, Komisioneri Publik vlerëson se gjetjet mbi këtë procedim penal, nisur dhe nga informacionet ndonëse të pakonfirmuara të përcjella nga agjencitë ligjzbatuese, duhen vlerësuar në zbatim të nenit 4, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, në funksion të nenit 61/5, të këtij ligji, pasi përftohen perceptime të rëndësishme mbi integritetin e subjektit të rivlerësimit, sipas parashikimit të nenit 75, pika 3 e ligjit nr. 96/2016, të ndryshuar.

23. Procedimi penal nr. *, datë **.6.2021, në lidhje me shtetasin *****

23.1 Nga aktet e administruara, rezulton se Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Sarandë, me shkresën nr. *** prot., datë **.10.2022, nënshkruar nga subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e drejtuesit të Prokurorisë, ka informuar Komisionin *se nga verifikimet në regjistrin elektronik dhe verifikimin manual në dosjet e ekzekutimeve të vendimeve penale për personat e dënuar, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Sarandë, nuk ka dosje penale me të dënuar shtetasin ***.***. Nga komunikimi zyrtar me zyrën e sektorit të gjendjes gjyqësore në Ministrinë e Drejtësisë rezulton se ky shtetas është dënuar përkatësisht në vitet 2013, 2017 dhe 2020, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Gjirokastrë.*

23.2 Komisioni, me *email*-in e datës **.11.2022, i ka kërkuar subjektit të *informojë nëse ka hetuar çështje penale në ngarkim të shtetasit ***.***, dhe nëse po, veprimet hetimore dhe ecurinë e hetimeve, duke i dokumentuar me akte shkresore.* Subjekti i rivlerësimit, me *email*-in e datës 25.11.2022, ndër të tjera, ka informuar se nuk ka hetuar çështje penale në ngarkim të shtetasit ***.***. Por, nëse për Komisionin paraqet interes për procedimin penal nr. ***/2021, në kuadër të të cilit janë zhvilluar hetime ndaj këtij shtetasi, subjekti, pasi prezanton disa rrethana mbi ecurinë e këtij procedimi²⁴, informon se në datën **.7.2022 është proceduar me vendim për zëvendësimin e prokurores ***.***, dhe hedhjen në short të çështjes, sipas të cilit, çështja është marrë në ngarkim nga subjekti i rivlerësimit. Subjekti informon gjithashtu se prej tij nuk është kryer asnjë veprim hetimor. Aktualisht, kjo çështje ndodhet për shqyrtim pranë gjyqtarit të seancës paraprake në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Sarandë.

23.3 Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni i ka kërkuar subjektit të japë sqarime, pasi duket se ka paqartësi në lidhje me procedurën e caktimit të çështjes subjektit të rivlerësimit përmes zëvendësimit të prokurores së mëparshme, duke paraqitur aktet procedurale të zëvendësimit të prokurores së çështjes nga ana e tij, si procesverbalet e hedhjes së shortit, vendimin e zëvendësimit etj., si dhe të vërtetojë me dokument shkresor statusin aktual të çështjes.

23.4 Në parashtrimet e tij, subjekti ka paraqitur shkresën nr. *** prot., datë **.12.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, sipas së cilës kërkesa “Për dërgimin e çështjes në gjyq dhe pushimin e pjesshëm të hetimeve”, në kuadër të procedimit penal nr. ***/2021, është duke u gjykuar në seancë paraprake. Referuar këtij fakti, subjekti ka sjellë në vëmendje sërish vendimin e Kolegjit nr. 33, datë 3.11.2021, lidhur me parashikimet e nenit E/2, të aneksit të Kushtetutës.

²⁴ “Hetimet për procedimin penal nr. ***/2021 janë drejtuar fillimisht nga prokurori ***.***, dhe pas transferimit të tij, nga prokurorja ***.***. Në përfundim të hetimeve, për shkaqe procedurale, për shtetasin ***.***, Gjykata ka refuzuar kërkesën e prokurores për zgjatjen e afatit të paraburgimit dhe ka konstatuar humbjen e fuqisë së paraburgimit, duke caktuar ndaj tij masën e sigurisë arrest në shtëpi. Duke e konsideruar qëndrimin e prokurores si neglizhencë të paqëllimtë dhe rezultat i ngarkesës në punë (me shkresën nr. *** prot., datë **.10.2022, është informuar KLP., mbi ngarkesën ekstreme të prokurorëve në Prokurorinë Sarandë, sipas të cilës prokurorja ***.***, deri në datë **.9.2022, rezultonte me 680 çështje, si dhe për shkak të eksperiencës së vogël në detyrë (2.5 vite), në cilësinë e Drejtuesit të Prokurorisë kam udhëzuar verbalisht të tregonte vëmendjen e duhur në drejtimin e çështjes.

Subjekti ka paraqitur akte lidhur me procedurën e zëvendësimit të prokurorit të çështjes dhe shortin²⁵.

23.5 Nga aktet e administruara, rezulton se procedimi penal ka të bëjë me ngjarjen e ndodhur në afërsi të lokalit “****”²⁶, në lagjen nr. ** Sarandë, ku në datë **.6.2021, janë plagosur dy shtetas. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë, ka regjistruar procedimin penal nr. ***/2021, në ngarkim të shtetasve ***.*** dhe ***.***, për veprat penale “Vrasja në rrethana të tjera cilësuese” kundër dy ose më shumë personave, e mbetur në tentativë, e kryer në bashkëpunim dhe “Mbajtja pa leje dhe prodhim i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municioneve”, parashikuar nga neni 79/dh, 22, 25 dhe 278/1, të K. Penal.

23.6 Në datën **.6.2022, rezulton se shtetasi ***.*** ka paraqitur pranë drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Sarandë, subjektit të rivlerësimit, kërkesë për përjashtimin e prokurores së çështjes znj. ***.***, duke pretenduar për paanësi në vlerësimin e çështjes dhe ngritjes së akuzës. Kjo kërkesë është protokolluar me nr. ***/*** prot., datë **.6.2022, dhe ka siglimin e drejtuesit të prokurorisë/subjektit të rivlerësimit, drejtuar prokurores së çështjes, me përmbajtjen “znj. ***/Në vlerësimin Tuaj”. Prokurorja e çështjes, ***.***, me vendimin e datës **.6.2022, e ka vlerësuar kërkesën të pabazuar, duke mos gjetur shkaqe ligjore për heqjen dorë nga çështja.

23.7 Në datën **.6.2022, shtetasi ***.***, ka paraqitur sërish para drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor, Sarandë, subjektit të rivlerësimit, kërkesë për përjashtimin e prokurores së çështjes, duke parashtruar të njëjtat pretendime si në kërkesën e datës **.6.2022. Kjo kërkesë është protokolluar me nr. *** prot., datë **.6.2022, dhe ka siglimin e drejtuesit të prokurorisë/subjektit të rivlerësimit, drejtuar prokurores së çështjes me përmbajtjen: “znj. ***/Më informoni mbi ecurinë e proc...”. Në vijim, prokurorja e çështjes, më datë **.6.2022, ka paraqitur drejtuesit të prokurorisë, subjektit të rivlerësimit: “Relacion mbi kërkesën për zëvendësim”, në të cilën vlerëson sërish se kërkesa e të pandehurit është e pabazuar, por në kushtet kur çështja paraqitet veçanërisht komplekse, e lë në vlerësimin e drejtuesit, nëse çmohet i nevojshëm zëvendësimi nga kjo çështje penale.

23.8 Në datën **.7.2022, subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e drejtuesit të prokurorisë, ka marrë vendimin për zëvendësimin e prokurorit, duke pranuar kërkesën e shtetasit ***.***, si dhe caktimin e një prokurori tjetër që do të zgjidhet me procedurën e shortit manual. Nga aktet rezulton se shorti është zhvilluar në datën **.7.2022, short nga i cili është zgjedhur subjekti i rivlerësimit.

23.9 Prokurorja znj. ***.***, në datën **.7.2022, ka nënshkruar deklaratë për heqjen dorë dhe nga hetimi i procedimit penal nr. ***/2022, që përmban akte të cilat shërbejnë për identifikimin

²⁵ (1) Vendimin për zëvendësimin e prokurorit ***.***, datë **.10.2021; (2) vendimin për zëvendësimin e prokurores ***.***, datë **.7.2022; (3) urdhër për zhvillimin e procedurave për hedhjen e shortit, datë **.7.2022; procesverbal për zhvillimin e procedurave për hedhjen e shortit datë **.7.2022; (4) kërkesë për përjashtimin e prokurores së çështjes, datë **.6.2022; (5) shkresë e datës **.6.2022 + vendim shqyrtim kërkesë datë **.6.2022; kërkesë për përjashtimin e prokurores së çështjes, datë **.6.2022; (6) relacion mbi kërkesën për zëvendësim të prokurores ***.***, datë **.6.2022; (7) vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Sarandë, datë **.8.2022, administruar në Prokurori në datën **.9.2022; (8) dëftesë komunikimi, datë **.9.2022, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë, për vendimin e datës **.8.2022; (9) shkresë nr. *** prot., datë **.9.2022, drejtuar Komisarariatit të Policisë Sarandë; deklaratë nga prokurore ***.***, datë **.7.2022, për heqjen dorë nga procedimi penal nr. ***/2022; (10) vendim për pranimin e kërkesës për heqje dorë të prokurorit, datë **.7.2022; (11) shkresë përcjellëse për Komisariatin e Policisë Sarandë, nr. *** prot., datë **.10.2022 + akt procedural, datë **.10.2022.

²⁶ https://***.*****/lajm/20-plumba-drejt-pronarit-te-orange-ne-sarande-3-autoret-u-nxorren-jashte-lokalit-dhe-filluan-ta-qellojine-me-arme-spiro-iljadhi-doli-jashte-kur-degjoji-krismat

e personave të tjerë të dyshuar për ngjarjen për të cilën është regjistruar procedimi penal nr. ***/2021.

23.10 Subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e prokurorit të çështjes, në datën **.9.2022, pa kryer vetë asnjë veprim hetimor, ka paraqitur pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Sarandë, dy kërkesa:

(1) *“Për dërgimin e çështjes në gjyq të procedimit penal nr. ***/2021”, për veprën penale “Mbajtja pa leje dhe prodhim i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municioneve”, parashikuar nga neni 278/1 të K. Penal në ngarkim të pandehurve ***.***, dhe ***.***, duke arsyetuar, ndër të tjera, se “Mbi bazën e veprimeve sa më sipër, prokurori i çështjes ka formuluar akuzë ndaj shtetasit ***.*** duke e akuzuar për kryerjen e veprës penale “Vrasja me dashje”, e mbetur në tentativë, e kryer në bashkëpunim dhe “Mbajtja pa leje dhe prodhim i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municioneve”, parashikuar nga neni 76, 22,25 dhe 278 i K. Penal. Akti i njoftimit të akuzës dhe marrjes si të pandehur ndaj shtetasit ***.***, rezulton i paqartë dhe madje i paplotë.”*

(2) *“Kërkesë për pushimin e pjesshëm të akuzës”, në funksion të çështjes penale nr. ***/2021, në ngarkim të pandehurit ***.***, për veprën penale “Vrasja me dashje”, e mbetur në tentativë, e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 76-22 dhe 25 të K. Penal.*

23.11 Komisioni, në përfundim ka vlerësuar për këtë çështje se ndodhet në kushtet e pengesës ligjore për vlerësimin e subjektit, sipas parashikimit të nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për këtë arsye, Komisioni nuk ka kryer verifikime dhe as i ka kërkuar sqarime/barrë prove subjektit në lidhje me kërkesat e paraqitura gjykatës për shtetasin ***.***. Referuar këtyre veprimeve të ndërmarra nga subjekti dhe rrethanave në të cilat është vlerësuar zëvendësimi i prokurores ***.***, Komisioni nuk mund të çmojë që informacionet e marra nga organet ligjzbatuese kanë qenë të vërteta. Për më tepër, këto informacione kanë qenë në kuadër dyshimesh të pavërtetuara me ndonjë të dhënë a provë konkrete.

24. Komisioneri Publik, në referencë të nenit E të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, në të tilla rrethana fakti dhe ligji, sa kohë procesi i rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit, në rastin konkret, do të përfundojë me marrjen e vendimit përfundimtar nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, ndryshe nga sa ka vendosur Komisioni, kërkon që kjo çështje të përfshihet në rrethin e vendimeve objekt vlerësimi në procesin e rivlerësimit të subjektit, duke u administruar eventualisht vendimi që do të merret në vijim nga Gjykata për rastin konkret.

24.1 Në vlerësimin e Komisionerit Publik, rrethanat e mësipërme të dala nga hetimi administrativ, duhen vlerësuar në zbatim të nenit 4, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, në funksion të nenit 61/5, të këtij ligji, pasi përftohen perceptime të rëndësishme mbi integritetin e subjektit të rivlerësimit, sipas parashikimit të nenit 75, pika 3 e ligjit nr. 96/2016, të ndryshuar.

III.C Lidhur me vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale

25. Referuar rezultateve të hetimit administrativ të Komisionit, lidhur me vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale, Komisioneri Publik çmon se subjekti i rivlerësimit nuk ka dhënë shpjegime bindëse që të provojnë të kundërtën e barrës së provës, mbi gjetjet e rezultuara nga aktet e administruara, akte këto që duhet të merren në shqyrtim nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, për sa në vijim:

26. Denoncim nga shtetasi ***.***²⁷. Procedimi penal nr. ***, datë **.9.2019

26.1 Denoncuesi, në parashtrimet e tij, referon se, në muajin shtator 2017, ka bërë kallëzim penal në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor, Vlorë për veprën penale të falsifikimit të dokumenteve, tjetërsim pronash dhe shpërdorim detyre, duke pretenduar se subjekti i rivlerësimit zvarrit çështjen penale prej dy vitesh, pushon çështjen pa marrë asnjë person nën hetim²⁸.

26.2 Komisioni ka administruar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Vlorë²⁹, dosjen e procedimit penal nr. ***/2017, nga ku ka rezultuar se në datën **.9.2017, subjekti i rivlerësimit ka vendosur regjistrimin e procedimit penal për kallëzimin e paraqitur nga shtetasi ***.***, për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186 i K. Penal.

26.3 Në vijim, subjekti i rivlerësimit, pasi kryen disa veprime: (i) në datën **.11.2017, vendos caktimin e ekspertit për kryerjen e ekspertimit tekniko-grafik të formularit nr. **, “Listë e familjeve që marrin tokë në pronësi”, nga ku ka rezultuar se ky akt ka shtesa dhe ndërhyrje nga persona që nuk kanë plotësuar formularin; (ii) në datën **.10.2018, sekuestron dokumentet pranë D.A.M.T. të Këshillit të Qarkut Vlorë, dhe (iii) në datën **.3.2019, njofton përfundimin e hetimeve shtetasin ***.***, përfundimisht në datën **.3.2019, vendos të dërgojë në gjykatë kërkesën për pushimin e çështjes penale nr. ***/2017.

26.4 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. ***, datë **.5.2019, ndër të tjera, mbi kërkesën e subjektit të rivlerësimit, ka arsyetuar se: [...] *nuk jemi në rastet kur duhet të pushohet procedimi penal, por duhet t'i kthehen aktet prokurorit me qëllim plotësimin e hetimeve... Kështu është e domosdoshme të hetohet nëse ky dokument është përdorur ndonjëherë prej shtetasit ***.***, dhe nëse ky ka pasur dijeni mbi falsitetin e dokumentit. Në këtë drejtim është e nevojshme të pyetet shtetasi ***.*** dhe të hetohet se si është përcjellë ky dokument në D.A.M.T., pranë Këshillit të Qarkut Vlorë [...].*

26.5 Sa më sipër Gjykata, ka vendosur: (i) Kthimin e akteve prokurorit me qëllim plotësimin e hetimeve lidhur me procedimin penal nr. ***, viti 2017, sipas drejtimeve të përcaktuara në pjesën arsyetuese; (ii) Veprimet hetimore të kryhen brenda 3 muajve.

26.6 Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim, subjekti i rivlerësimit dhe Gjykata e Apelit Vlorë me vendimin nr. ***, datë **.7.2019, ndër të tjera, ka arsyetuar se: [...] *Vendimi gjyqësor penal nr.***, datë **.5.2019, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, është rrjedhojë e zbatimit korrekt të ligjit procedural penal dhe si i tillë duhet të lihet në fuqi. Gjykata pasi analizoi provat e mbledhura nga organi i akuzës gjatë hetimeve paraprake, vlerëson se hetimet nuk janë të plota, gjithëpërfshirëse dhe shteruese e për rrjedhojë prokurori nuk duhet të dispononte për kërkimin e “pushimit të çështjes” pa kryer minimalisht edhe disa veprime hetimore shumë të rëndësishme në procedime të këtij karakteri e për këtë lloj vepre penale... Në këtë rast, Gjykata vëren se për zgjidhjen e çështjes objekt gjykimi do t'i referohemi neneve 328 dhe 329/a të K. Procedurës Penale, të cilët respektivisht sanksionojnë:1-Të kryhen verifikime nëse ky dokument është përdorur ose jo, duke u pyetur për këtë kallëzuesi ***.***;2- Prokurori duhet të urdhërojë kryerjen e një akt-ekspertimi për të konstatuar nëse ndërhyrjet në dokument janë bërë nga shtetasi*

²⁷ Referohuni denoncimit nr. *** prot., datë **.4.2019 në dosjen e Komisionit.

²⁸ Denoncuesi ka bashkëngjitur denoncimit këto akte: (i) kërkesë për pushimin e çështjes penale nr. ***/2017; (ii) kallëzim penal; (iii) akt-ekspertimi tekniko grafik nr. ***, datë **.12.2017.

²⁹ Referohuni shkresës nr. *** prot., datë **.4.2022, në dosjen e Komisionit.

i kallëzuar apo jo; 3-Të hetohet se si ky dokument është përcjellë në D.A.M.T., pranë Këshillit të Qarkut Vlorë [...].

26.7 Kallëzuesi ***.*** ka paraqitur Memo, ku ka kërkuar kryerjen e veprimeve hetimore, informacion në lidhje me to, si dhe të njihet me aktet e procedimit. Nga aktet e administruara, nuk rezulton të jetë kthyer përgjigje referuar nenit 110 të K. Pr. Penale.

26.8 Në datën **.11.2020, subjekti i rivlerësimit urdhëron regjistrimin e emrit të personit që i atribuohet vepra penale ***.***. Në vijim ka vendosur marrjen e tij si të pandehur, njoftimin e akuzës, për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186 i K. Penal, si dhe njoftimin e shtetasve ***.*** dhe ***.***, për përfundimin e hetimeve. Në datën **.1.2021 është protokolluar kërkesa nga avokati i të pandehurit, me anë të cilës kanë kërkuar kryerjen e hetimeve shtesë që konsiston në kryerjen e aktit të ekspertimit tekniko grafik të të pandehurit ***.***, pasi gjatë hetimeve nuk ishte kryer. Nuk rezulton të ketë vendim të prokurorit në lidhje me kërkesën e të pandehurit për kryerjen e aktit të ekspertimit, detyrë e lënë dhe nga gjykata.

26.9 Në datën **.1.2021, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar dërgimin për gjykim të procedimit penal nr. ***/2017, në ngarkim të pandehurit ***.***, për kryerjen e veprës penale “Falsifikim i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186/1 i K. Penal, me arsyetimin se ka përdorur dokument të falsifikuar. Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Vlorë me vendimin nr. ***, datë **.4.2021, ka vendosur dërgimin në gjyq të procedimit penal nr. ***, viti 2017.

26.10 Komisioni, nga analizimi i akteve të dosjes penale, i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës, pasi duket se:

(i) Nga data **.9.2017, e regjistrimit të procedimit penal, pa emër autori, deri në datën **.03.2019, të dërgimit të kërkesës në gjykatë për pushimin e procedimit penal, çështja ka zgjatur pothuajse 1 vit e 6 gjashtë muaj dhe gjatë kësaj periudhe vërehen intervale kohore nga 9 muaj dhe 5 muaj, pa kryer veprime hetimore;

(ii) Pas vendimit nr. ***, datë **.5.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Vlorë, nga ana e prokurorit nuk është kryer akt-ekspertimi me qëllim përcaktimin nëse ndërhyrjet janë bërë nga shtetasi ***.***, veprim i cili është kërkuar edhe nga ana e të pandehurit.

(iii) Vendimi i formës së prerë nr. ***, datë **.5.2019, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Vlorë, i cili ka vendosur plotësimin e hetimeve brenda 3 muajve, i është komunikuar prokurorit K. Llaho në datë **.8.2019, dhe subjekti i rivlerësimit deri në datën **.6.2020, pra, për një periudhë rreth 10-mujore, nuk ka kryer asnjë veprim hetimor.

26.11 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të barrës së provës, ndër të tjera, sqaroi se dosja ndodhet në gjykim pranë gjyqtarës ***.***, për gjykimin në themel të çështjes dhe nuk ka ende vendim përfundimtar. Sa i takon konstatimit të parë që ka lidhje me moskryerjen e hetimeve për periudhën 9 dhe 5 muaj, subjekti ka pretenduar se kjo ka ardhur si pasojë e ngarkesës në punë. Sa i takon konstatimit të dytë, subjekti pretendoi se vlerësimi i gjykatës është i gabuar, duke paraqitur të njëjtat argumente të parashtruara dhe në ankimin e paraqitur kundër vendimit nr. ***, datë **.5.2019.

26.12 Komisioni, në përfundim të vlerësimit të çështjes, pasi e ka konsideruar të pabazuar pretendimet e përsëritura të subjektit të rivlerësimit, lidhur me parashikimet e nenit E/2, të aneksit të Kushtetutës, ka konstatuar se mosrespektimi i afatit tremujor sipas vendimit nr. ***, datë

**5.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, është i vetmi rast i kësaj natyre evidentuar për subjektin e rivlerësimit.

27. Komisioneri Publik, ndryshe nga sa ka konkluduar Komisioni, vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provonte të kundërtën e barrës së provës. Komisioneri Publik, në konsideratë dhe të jurisprudencës së Kolegjit, lidhur me shkakun e ankimit të mësipërm, dhe me vlerësimin në tërësi të çështjes, vëren se në rastet kur gabimet e subjekteve të rivlerësimit evidentohen që përsëriten në mënyrë të vazhdueshme dhe në praktika të ndryshme, përbëjnë përjashtim nga rastet e konfirmimit në detyrë dhe duhet të vlerësohen negativisht³⁰.

27.1 Komisioneri Publik, ashtu sikurse ka orientuar Kolegji në jurisprudencën e tij, çmon se këto gjetje, duhen vlerësuar në funksion të nenit 4, pika 2 të ligjit nr. 84/2016, lidhur me parashikimet e nenit 61, pika 5 e të njëjtit ligj.

28. Denoncim nga shtetasi *.***, dhe të tjerë³¹. Procedimi penal nr. ***, datë **9.2015**

28.1 Denoncuesit pretendojnë se subjekti i rivlerësimit nuk ka marrë masa ndaj shtetasit ***.***, duke çuar çështjen në gjykim vetëm për shtetasin ***.***, në bazë të nenit 134, paragrafi i parë, megjithëse kanë qenë faktet dhe kushtet për aplikimin e paragrafit të tretë të kësaj dispozite³².

28.2 Komisioni ka administruar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Vlorë³³ dosjen e procedimit penal nr. ***/2015, ku nga shqyrtimi i akteve, në mënyrë të përmbledhur, ka konstatuar se:

28.3 Sindikata e Pavarur e ***(***)**, ka paraqitur kallëzim nr. ***, datë **5.2015, ndaj shtetasve ***.*** dhe ***.***, të akuzuar për veprën penale të falsifikimit të dokumenteve dhe vjedhjes, duke shpërdoruar detyrën. Pas regjistrimit të kallëzimit penal, pasi janë kryer disa veprime hetimore, në datën **9.2015, subjekti i rivlerësimit ka regjistruar procedimin penal nr. *** për veprën penale: “Vjedhje duke shpërdoruar detyrën”, parashikuar nga neni 135, i K. Penal.

28.4 Nga aktet e administruara, duket se në datë **11.2015 dhe **.1.2016, janë paraqitur edhe dy kallëzime penale të tjera, respektivisht nga Sindikata e Pavarur e ***(***) në Shqipëri dhe Sindikata e Pavarur e ***(***)/Federata e ***(***)**, ndaj shtetasit ***.*** dhe ***.***, për veprën penale të vjedhjes, duke shpërdoruar detyrën, si dhe falsifikimit të dokumenteve. Këto materiale kallëzuese janë bashkuar me aktet e procedimit penal nr. ***/2015.

28.5 Në vijim, pasi janë kryer veprime të tjera hetimore, në datën **12.2017, subjekti i rivlerësimit ka njoftuar kallëzuesit ***.***, dhe ***.***, për përfundimin e hetimeve të procedimit penal nr. ***/2015. Subjekti i rivlerësimit, me shkresën nr. *** prot., datë **12.2017, ka dërguar në gjykatë kërkesën për pushimin e çështjes penale nr. ***/2015.

28.6 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. ***, datë **.2.2018, ka vendosur kthimin e akteve prokurorit dhe urdhërimin të formulojë akuzë në ngarkim të shtetasve ***.***

³⁰ Referohuni vendimit nr. 2/2020 të Kolegjit, prg. 32.5.

³¹ Referohuni denoncimit nr. *** prot., datë **10.2019, në dosjen e Komisionit.

³² Bashkëngjitur denoncimit janë paraqitur disa akte si: (i) Vendim nr. *** datë **03.2019, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë; (ii) Vendim nr. *** datë **06.2019, i Gjykatës së Apelit Vlorë; (iii) Vendim nr. *** datë **7.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Fier, lënë në fuqi me vendim nr. *** datë **7.2018 të Gjykatës së Apelit, Vlorë.

³³ Referohuni shkresës nr. *** prot., datë **5.2022 të Prokurorisë pranë Shkallës së parë, Vlorë.

dhe ***.***, për veprën penale “Vjedhje”, në bashkëpunim parashikuar nga neni 134/2 i Kodit Penal. Gjykata, ndër të tjera, ka arsyetuar se: [...] (i) rezulton se me vendim të Gjykatës së Fierit nr. ***, datë **7.2016,³⁴ shtetasit ***.***, ***.***, ***.*** dhe ***.***, janë deklaruar fajtorë për veprën penale të “Falsifikimit të dokumenteve”; (ii) shtetasit ***.***, ***.*** kanë tërhequr shumat; (iii) sipas ekspertit kontabël dhe kreditimet e debitimet në *** Bank, është e qartë se kanë përvetësuar shumën 1.547.200 lekë; (iv) në këto kushte janë prova të mjaftueshme për të formuluar akuzën e “Vjedhjes” kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 134/2 të K. Penal. [...] Ky vendim është ankimuar nga prokurori/subjekti i rivlerësimit.

28.7 Gjykata e Apelit Vlorë, me vendim nr. ***, datë **6.2018, ka prishur vendimin e gjyqtarit të seancës paraprake duke vendosur pushimin e procedimit penal nr. *** datë **9.2015, lidhur me veprën penale “Vjedhje duke shpërdoruar detyrën”, parashikuar nga neni 135 i K. Penal.

28.8 Në datën **10.2018, subjektit të rivlerësimit i ka kaluar për ndjekje nga drejtuesi i prokurorisë, kallëzimi penal nr. ***/2018, nga shtetasi ***.***, ***.***, ***.*** dhe ***.***, ndaj shtetasve ***.***, ***.*** dhe ***.***.

28.9 Në datën **11.2018, subjekti i rivlerësimit, ka paraqitur kërkesë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Vlorë me objekt: revokimin e vendimit të pushimit të çështjes penale nr. ***/2015, me arsyetimin se: “... me vendimin nr. ***, datë **7.2018, të Gjykatës së Apelit Vlorë³⁵, janë deklaruar fajtor shtetasit ***.***, ***.***, ***.*** dhe ***.***, për veprën penale të “falsifikimit të dokumenteve” parashikuar nga neni 186/2 i K. Penal”.

28.10 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendim nr. *** akti, datë **11.2018, ka vendosur revokimin e vendimit të pushimit të çështjes penale nr. ***/2015, e pushuar me vendim nr. *** datë **6.2018, të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe kthimin e akteve prokurorit.

28.11 Në datën **11.2018, subjekti i rivlerësimit ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal nr. ***/2018, në ngarkim të shtetasit ***.***, për veprën penale “vjedhje”, parashikuar nga neni 134/1 i K. Penal. Në vijim, prokurori ka urdhëruar bashkimin e procedimit penal nr. ***/2015 dhe nr. ***/2018, në një procedim të vetëm, atë me nr. ***/2015. Subjekti i rivlerësimit ka kërkuar caktimin e masës së sigurimit personal për shtetasin ***.***, “arrest në burg”, kërkesë e cila është pranuar nga Gjykata, si dhe ka vendosur marrjen si të pandehur dhe njoftimin e akuzës për shtetasin ***.***, për veprën penale të “vjedhja” parashikuar nga neni 134/1 i K. Penal.

28.12 Në datën **2.2019, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar dërgimin në gjykatë të procedimit penal nr. ***/2015, në ngarkim të shtetasit ***.***, i akuzuar për veprën penale “Vjedhja”, parashikuar nga neni 134/1 i K. Penal. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. ***, datë **3.2019, ndër të tjera, ka vendosur: “... 1. Kthimin e akteve prokurorit dhe urdhërimin të ndryshojë cilësimin juridik lidhur me të pandehurin ***.***. duke akuzuar për veprën penale “vjedhja” me pasoja të rënda në bashkëpunim, parashikuar nga neni 134/2 dhe 25 i K. Penal; (ii) të formulojë akuzë në ngarkim të shtetasit ***.*** për veprën penale “vjedhja” me pasoja të rënda në bashkëpunim, parashikuar nga neni 134/2 dhe 25 i K. Penal”.

28.13 Gjykata, në arsyetimin e saj, ndër të tjera, ka arsyetuar se: [...] *rezulton e provuar se shtetasi ***.*** ka bashkëpunuar me shtetasin ***.*** për marrjen e detyrës nga ky i fundit, me*

³⁴ Ky vendim është lënë në fuqi me vendimin e Gjykatës së Apelit Vlorë, nr. ***, datë **6.2018.

³⁵ Vendim që ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier nr. ***, datë **7.2016, në të cilin është deklaruar fajtor, ndër të tjerë, shtetasit ***.*** dhe ***.***, lidhur me kryerjen e veprës penale “Falsifikim i dokumenteve”.

qëllimin e përbashkët dhe të vetëm, shtënien në dorë të të ardhurave [...]. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim, subjekti i rivlerësimit dhe i pandehuri ***.***.

28.14 Gjykata e Apelit Vlorë, me vendim nr. ***, datë **.06.2019, ka vendosur mospranimin e ankimit, duke arsyetuar se: [...] nga sa më sipër, përderisa dispozita nuk lejon në mënyrë të shprehur ankim ndaj vendimit të Gjykatës për kthimin e akteve prokurorit, me qëllim që ky i fundit të formulohet akuzë të re apo të formulohet qartë dhe saktë akuzën, Gjykata e Apelit Vlorë, nuk mund të marrë në shqyrtim vendimin nr. ***, datë **.3.2019 dhe as ankimin kundër këtij vendimi dhe në kushte të tilla konkludon të vendosë mospranimin e ankimit [...].

28.15 Në datën **.9.2019, është administruar vendimi i formës së prerë nr. *** datë **.03.2019, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, dhe në datën **.9.2019, subjekti i rivlerësimit ka urdhëruar regjistrimin e emrit të autorit të veprës penale shtetasin ***.***, për veprën penale vjedhja me pasoja të rënda, parashikuar nga neni 134/2 dhe 134/3 të K. Penal. Më tej, me vendimin datë **.10.2019, subjekti i rivlerësimit ka vendosur marrjen e shtetasit ***.*** dhe ***.***, si të pandehur për kryerjen e veprës penale “Vjedhja” e kryer në bashkëpunim, me pasoja të rënda parashikuar nga neni 134/2 dhe 134/3 të K. Penal.

28.16 Në datën **.11.2019, subjekti i rivlerësimit ka dërguar në gjykatë kërkesën për dërgimin e çështjes në gjyq të procedimit nr. ***/2015, në ngarkim të shtetasve ***.***, dhe ***.***, për veprën penale “vjedhja” me pasoja të rënda parashikuar nga neni 134/2 dhe 134/3 të K. Penal.

28.17 Komisioni, në përfundim të hetimit administrativ, nga shqyrtimi i akteve të mësipërme, i ka kaluar subjektit barrën e provës, pasi duket se: (i) Nga data e regjistrimit të kallëzimit penal **.5.2015 deri në datën e regjistrimit të procedimit penal, në datë **.9.2015, ka kaluar një kohë prej 3 muaj e gjysmë, pra përtej afatit 30-ditor sipas udhëzimit të Prokurorit të Përgjithshëm nr.241, datë 21.11.2005, i ndryshuar; (ii) Sipas vendimit të formës së prerë nr. *** datë **.3.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, kërkesa e subjektit datë **.2.2019, për dërgimin e çështjes në gjykim vetëm me një të akuzuar ***.***, ka pasur mangësi në hetime dhe ngritjen e akuzës.

28.18 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të rezultateve të hetimit, ndër të tjera, ka paraqitur vendimin nr. ***, datë **.7.2021, sipas të cilit është vendosur dërgimi i çështjes për gjykim me të pandehurit ***.*** dhe ***.***, si dhe shkresën e lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, sipas të cilës çështja është në gjykim pranë kësaj gjykate, duke sjellë në vëmendje pengesën ligjore sipas nenit E/2, të aneksit të Kushtetutës.

28.19 Komisioni, në vlerësimin përfundimtar të çështjes, pasi e ka konsideruar të pa bazuar pretendimin e subjektit mbi pengesën e parashikuar nga neni E/2, i aneksit të Kushtetutës për vlerësimin e këtij rasti, në analizë të të gjitha veprimeve të kryera nga subjekti, ka konstatuar se subjekti ka përmbushur detyrat e tij si prokuror, dhe se, si regjistrimi i çështjes tej afatit 30-ditor, ashtu edhe ngritja e akuzës dhe vlerësimi fillimisht për marrjen të pandehur vetëm të një personi, nuk kanë qenë me qëllim zvarritjen e hetimeve dhe as favorizimin e ndonjë të pandehuri.

29. Komisioneri Publik, ndryshe nga sa ka konkluduar Komisioni, vlerëson se subjekti nuk arriti të provonte të kundërtën e barrës së provës, dhe qëndrojnë pretendimet e denoncuesit në raport me mungesën e akuzës së ngritur ndaj shtetasit ***.***, dhe afatit të tejzgjatur të çështjes. Subjekti, dhe në këtë rast, më së paku, tregoi mangësi në efikasitetin hetimor, lidhur me ndërmarrjen e hetimit sipas kërkesave ligjore, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj, si dhe për të përballuar ngarkesën e punës. Komisioneri Publik, dhe në rastin konkret, vlerëson se ka rrethana, të cilat duhen vlerësuar në zbatim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në funksion të

analizimit të nënindikatorëve të përcaktuar nga neni 73/2 dhe 74/1 të ligjit nr. 96/2016, i ndryshuar.

30. Lidhur me etikën dhe profesionalizmin referuar nenit 75/4 të ligjit nr. 96/2016

30.1 ILDKPKI, në përfundim të aktit të kontrollit të pasurisë, ndër të tjera, ka konstatuar se: [...] *Është e paqartë marrëdhënia juridike që ka subjekti me shtetasit ***.***, ***.***, si dhe me shoqërinë e ndërtimit “***.***” sh.p.k, të cilët i kanë dhënë në përdorim apartamentin me sip. 105 m² në Vlorë, pa qira [...].*

30.2 Në përgjigje të Pyetësorit nr. 2, subjekti deklaroi se shoqëria “***.***” sh.p.k., është në cilësinë e sipërmarrësit të punimeve në këtë pallat, ku investitore dhe përfitues të apartamenteve janë shtetasit ***.*** (dhe djali i tij ***.***), me të cilin është dakordësuar verbalisht për të përdorur apartamentin në katin e shtatë pa pagesë qiraje. Subjekti deklaron se nuk është nënshkruar ndonjë kontratë huaje apo qiraje, përveç deklaratës datë **.1.2017, lëshuar nga shtetasi ***.***. Sa i takon marrëdhëniet me shoqërinë “***.***” sh.p.k, subjekti ka deklaruar se me shoqërinë “***.***” sh.p.k dhe administratorin e saj, ***.***, nuk ka asnjë lidhje/marrëdhënie apo ndikim në këtë marrëdhënie. Sipas subjektit, “***.***” sh.p.k. ka qenë në cilësinë e shoqërisë sipërmarrëse, ndërsa investitore dhe përfitues të numrit më të madh të apartamenteve kanë qenë familjet e ***. dhe ***.***.

30.3 Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, fillimisht me shkresën nr.*** prot., datë **.3.2022, ka informuar se: (i) Për shoqërinë “***.***” sh.p.k, nuk rezulton të jetë regjistruar kallëzim/procedim penal; (ii) Për shtetasin ***.***, rezulton të jenë regjistruar kallëzimet penale nr. ***/2018 dhe nr. ***/2021, trajtuar nga subjekti i rivlerësimit me vendim mosfillim procedimi penal.

30.4 Në vijim, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, me shkresën nr. *** prot., datë **.4.2022, ka informuar Komisionin se gjatë verifikimeve në regjistrin manual ka rezultuar se subjekti i mësipërm ka pasur në hetim edhe procedimin penal nr. ***/2017, për veprën penale të parashikuar nga neni 186 i K. Penal. Në këtë procedim shtetasi ***.***, në cilësinë e administratorit të shoqërisë “***.***” sh.p.k., ka kërkuar zëvendësimin e prokurorit, subjektit të rivlerësimit, ndër të tjera, duke vendosur në vëmendje kërkesën për zëvendësim të bërë dhe në një procedim të mëparshëm, atë me nr. ***/2016.

30.5 Nga aktet e përcjella, rezulton se Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Vlorë, ka regjistruar procedimin penal nr. *** të vitit 2016, për veprat penale të parashikuara nga nenet 186 dhe 248 të K. Penal. Kallëzimi është bërë nga shtetasi ***.***, i cili ka pretenduar se nga ana e shtetasve ***.*** dhe ***.***, është falsifikuar skica e vërtetimit të pronësisë së pronës prej 2.600 m² truall, mbi të cilin subjekti ndërtues “***.***” sh.p.k. me administrator ***.***, ka ndërtuar dy objekte banimi 8-9 kate. Ky procedim penal hetohej nga subjekti i rivlerësimit.

30.6 Shtetasi ***.***, me kërkesën të datës **.7.2017, ka kërkuar zëvendësimin e prokurorit të çështjes/subjektit të rivlerësimit, ndër të tjera, duke argumentuar se: [...] *Rezulton se në objektin e banimit 8-katësh, i cili ndodhet përbri dy objekteve të ndërtuara nga subjekti ndërtues “***.***”, ka marrë një banesë me qira përpara rreth tre muajsh shtetasi Kledian Llaho, i cili rezulton të jetë edhe prokurori i çështjes, që është duke hetuar kallëzimin penal të bërë nga shtetasi ***.***, për të cilin është regjistruar kallëzimi penal nr. ***/2016. Ky shtetas, vetëm pak ditë pasi ka filluar të banojë në banesën e marrë me qira, është paraqitur tek ambientet e subjektit ndërtues dhe më është prezantuar si prokuror, pasi ra në dijeni se isha administratori i*

subjektit ndërtues, të hiqja antenën e kompanisë ..., e cila është vendosur në terracën e njërit prej objekteve të ndërtuar nga subjekti ndërtues “***.***”[...].

30.7 Drejtuesi i Prokurorisë, me vendimin e datës *.7.2017, ka pranuar kërkesën e shtetasit ***.***, për zëvendësimin e subjektit të rivlerësimit nga hetimi i mëtejshëm i procedimit penal nr. ***/2016, ndër të tjera, duke arsyetuar se: [...] Nga të dhënat e mësipërme, rezulton se ndërmjet kërkuarit dhe prokurorit të çështjes ekziston një mosmarrëveshje... Në këto kushte del e qartë se ndodhemi para një shkak ligjor për zëvendësimin e prokurorit[...]. E njëjta situatë dhe e njëjta arsye konflikti, ka shërbyer për zëvendësimin e subjektit të rivlerësimit dhe në procedimin penal nr. ***/2017, me kërkesën e shtetasit ***.***.

30.8 Komisioni, lidhur me hetimin administrativ të këtij rasti, të trajtuar më gjerësisht dhe në vendimin nr. 607/2022 të tij, ka arritur në konkluzionin se nuk kanë rezultuar problematika e dyshime në lidhje me apartamentin e përdorur për një periudhë prej një viti nga subjekti në Vlorë pa pagesë, deklaruar në DV-2016 dhe në Deklaratën “Vetting”. Nga aktet e procedimit penal nr. ***/2017, dhe atij me nr. ***/2016 rezulton se në të dyja këto raste, prokurori Kledian Llaho, është zëvendësuar me urdhër të drejtuesit të Prokurorisë për shkak të kërkesës së shtetasit ***.***, i kallëzuar penalisht, i cili ka ngritur pretendime për mosmarrëveshje me subjektin e rivlerësimit.

31. Komisioneri Publik, në analizë të situatës faktike të përshkruar më sipër, vlerëson se prapësimet e subjektit, si dhe qëndrimi i Komisionit nuk mbështeten nga aktet në dosje, në jurisprudencën dhe qëndrimet e Kolegjit në trajtimin e rasteve të ngjashme, lidhur me dilijencën e duhur që subjekti duhej të kishte trajtuar në konstatimin e gjendjes së konfliktit të interesit, që në rastin konkret është i ndërthurur, jo vetëm në drejtim të interesit pasuror, bazuar në dispozitat e ligjit nr.9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, por dhe në zbatim të dispozitave procedurale të nenit 17 të K. Pr. Penale.

31.1 Komisioneri Publik vlerëson se dhe në rastin konkret ka vend vlerësimi nga ana e Kolegjit lidhur me nënindiktorët e përcaktuar nga neni 75/4 i ligjit nr. 96/2016, lidhur me kujdesin e treguar ndaj konfliktit të interesit.

32. Në përfundim të vlerësimit të vendimit nr. 607/2022 të Komisionit, Komisioneri Publik, ashtu sikurse dhe Kolegji, ka arsyetuar në jurisprudencën e tij³⁶, parë nga këndvështrimi i publikut, konstaton gjendjen e cenimit të besimit të publikut për subjektin e rivlerësimit, z. Kledian Llaho, mbi bazën e një analize të detajuar sa më sipër, që mori në konsideratë: (i) mangësitë në kontrollin e pasurisë; (ii) informacionet e organeve ligjzbatuese; (iii) denoncimet nga publiku dhe gjetjet në aspektin profesional; (iv) ndërthurjen e interesave personale dhe gjendjes së konfliktit të interesit.

32.1 Në përmbledhje të sa më sipër, në analizë të problematikave të konstatuara, në një vlerësim të përgjithshëm të të tria kritereve të rivlerësimit dhe pas një vlerësimi tërësor të procedurave sipas parashikimit të nenit 4, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e cenimit të besimit të publikut të sistemi i drejtësisë, sipas parashikimit të nenit 61, pika 5 e këtij ligji.

³⁶ Referuar vendimit (JR) nr. 11/2022, të Kolegjit, prg. 43-44.

IV. Kërkimi i ankimit

33. Nisur nga parashikimi i nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës dhe aneksit të Kushtetutës, konsiderojmë se, ndryshe nga sa disponon Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, për kriteret e rivlerësimit, referuar gjendjes së fakteve dhe provave në rastin konkret, Komisioneri Publik ndan gjykim të kundërt, pasi vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm për konfirmimin e tij në detyrë;

34. Duke ritheksuar se Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, me qëllim që të garantojë mbrojtjen e interesit publik në procesin e rivlerësimit, duke vlerësuar në qoftë se vendimmarrja e Komisionit për konfirmimin ose shkarkimin e subjektit, ose ndërprerjen e procesit të rivlerësimit është marrë në përputhje me ligjin, në përfundim të një hetimi të plotë, mbështetur në faktet dhe provat e administruara për këtë qëllim;

35. Nisur nga fakti se Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit, ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit nga ana e Komisionit;

36. Bazuar në nenin Ç, E, D, DH dhe F, të aneksit të Kushtetutës, Kreun VI dhe nenin 61, pika 5, të ligjit nr. 84/2016;

37. Komisioneri Publik kërkon që shkaqet e këtij ankimi të merren në shqyrtim nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe, në zbatim të nenit 66, pika 1, germa “b”, të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të shqyrtimit të çështjes në seancë publike, të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit nr. 607, datë 22.12.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Kledian Llaho.

KOMISIONERI PUBLIK

Florian BALLHYSA